

**Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e
Legjislacionit Mjedisor**

Një projekt për Shqipëri financuar nga Bashkimi Evropian

Draft

Vendim për Raportet e Sigurisë dhe Planet e Emergjencës*

Drafti 1

Versioni 1

20.09. 2010

* Ky Vendim transponon Direktivën 96/82/EC për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që shkaktohen nga substancat kimike, amenduar nga Rregullorja EC/1882/2003, Direktiva 2003/105/EC dhe Rregullorja EC/1137/2008, në lidhje me Raportet e Sigurisë dhe Planet e Emergjencës.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

DRAFTI 1 Versioni 1

20.09. 2010

VENDIM

Nr _____, datë _____

**PËR RAPORTET E SIGURISË DHE PLANET E EMERGJENCËS SIPAS
LIGJIT PËR KONTROLLIN E RREZIQEVE NGA AKSIDENTET
MADHORE QË SHKAKTOHEN NGA SUBSTANCA KIMIKE (1)**

Në mbështetje të Neneve 59 paragrafi 1.d dhe 100 të Kushtetutës dhe **Nenit 9.15, 11.5 dhe 12,13** të Ligjit nr _____, datë _____ “Për Kontrollin e Rreziqeve nga Aksidentet Madhore që shkaktohen nga substanca kimike”, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. Dispozita të Përgjithshme

1. Ky Vendim përcakton udhëzimet për Raportet e Sigurisë, Planet e Brendshme të Emergjencës dhe Planet e Jashtme të Emergjencës, që duhen marrë në konsideratë gjatë hartimit të këtyre Raporteve dhe Planeve, kur është e përshtatshme.
2. Për qëllime të këtij Vendimi, të gjitha termat e përdorura kanë kuptimin që u është dhënë nga Neni 2 i Ligjit “Për Kontrollin e Rreziqeve nga Aksidentet Madhore”.

II. Raportet e Sigurisë

3. Operatori i ndërmarrjes së Nivelit më të Lartë në bazë të Kreut 3 të Ligjit duhet të përgatisë Raportin e Sigurisë në lidhje me atë ndërmarrje që është e mjaftueshme për qëllimet e përcaktuara në Pjesën 1 të Aneksit 3 të Rregullores

* Ky Vendim transponon Direktivën 96/82/EC për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që shkaktohen nga substancat kimike, amenduar nga Rregullorja EC/1882/2003, Direktiva 2003/105/EC dhe Rregullorja EC/1137/2008, në lidhje me Raportet e Sigurisë dhe Planet e Emergjencës.

dhe që përmban të paktën informacionin e specifikuar në Pjesën 2 të atij Aneksi.

4. Udhëzimet për Raportet e Sigurisë të përcaktuara në Aneksin e këtij Vendimi merren në konsideratë, kur duhet, nga operatori gjatë përgatitjes së Raportit të Sigurisë për atë ndërmarrje.

III. Planet e Brendshme të Emergjencës

5. Në bazë të Kreut 4 të Rregullores, operatori i Ndërmarrjes së Nivelit më të Lartë duhet të përgatisë Planin e Brendshëm të Emergjencës në lidhje me atë ndërmarrje që është e përshtatshme për sigurimin e objektivave të specifikuara në Pjesën 1 të Aneksit 5 të Ligjit dhe përmban informacionin e specifikuar në Pjesën 2 të këtij Aneksi.
6. Udhëzimet për Planet e Emergjencës të përcaktuara në Aneksin e këtij Vendimi merren në konsideratë, kur duhet, nga operatori gjatë përgatitjes së Planit të Brendshëm të Emergjencës për atë ndërmarrje.

IV. Planet e Jashtme të Emergjencës

7. Njësia e qeverisjes vendore në zonën e së cilës ndodhet ndërmarrja e Nivelit më të Lartë, duhet, në bazë të Kreut 4 të Ligjit, të përgatisë Planin e Jashtëm të Emergjencës në lidhje me atë ndërmarrje. Plani i Jashtëm i Emergjencës duhet të jetë i përshtatshëm për sigurimin e objektivave të specifikuara në Pjesën 1 të Aneksit 5 të Rregullores dhe të përmbajë informacionin e specifikuar në Pjesën 3 të këtij Aneksi.
8. Udhëzimet për Planet e Emergjencës të përcaktuara në Aneksin e këtij Vendimi merren parasysh, kur duhet, nga njësia e qeverisjes vendore gjatë përgatitjes së Planit të Jashtëm të Emergjencës për atë ndërmarrje.

V. Dispozita e Fundit

9. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

Aneks

1. Hyrje

1. Ligji “Për Kontrollin e Rreziqeve nga Aksidentet Madhore” synon parandalimin e aksidenteve madhore që shkaktohen nga substanca të rrezikshme dhe kufizimin e pasojave të tyre tek njeriu dhe mjedisi.
2. Kërkesat për Raportin e Sigurisë, Plani i Brendshëm i Emergjencës dhe Plani i Jashtëm i Emergjencës përfshihen në Ligj si disa nga masat kryesore për të arritur këtë synim.
3. Ky Vendim ka për qëllim të ofrojë udhëzime të mëtejshme për të ndihmuar interpretimin e kërkesave të Raporteve të Sigurisë dhe Planeve të Emergjencës që përmban Ligji.
4. Udhëzimi për Raportet e Sigurisë është i dobishëm për operatorët e ndërmarrjeve të Niveleve më të Larta dhe Autoritetet Kompetente. Udhëzimi për Planet e Emergjencës është i dobishëm për të gjithë ata që kanë përgjegjësi për hartimin e planeve të emergjencës si të brendshme ashtu edhe të jashtme, në lidhje me ndërmarrjet e Nivelit më të Lartë, përfshirë: operatorët, autoritetet Kompetente, autoritetet vendore dhe shërbimet e emergjencës.

2. Udhëzime për përgatitjen e Raporteve të Sigurisë

2.1 Hyrje

1. Raporti i Sigurisë është pjesë e rëndësishme e kontroleve për ndërmarrjet e Nivelit më të Lartë. Ai është një përshkrim konçiz i operimit të sigurt dhe pa ndikim negativ në mjedis gjatë ciklit të jetës së instalimeve për përpunimin apo magazinimin e substancave të rrezikshme. Informacioni i mbledhur për raportin e sigurisë duhet të identifikojë aksidentet madhore, përshkruajë të gjitha masat e marra për parandalimin e aksidenteve të tilla dhe kufizimin e pasojave nga të gjitha aksidentet që ndodhin. Raporti i Sigurisë është evidencë që operatori ka analizuar me kujdes masat parandaluese dhe të kontrollit.
2. Natyra dhe shkalla e informacionit që kërkohet në Raportin e Sigurisë varet nga madhësia dhe kompleksiteti i ndërmarrjes, rreziqet nga aksidentet madhore dhe natyra e mjedisit rreth territorit të ndërmarrjes.
3. Nëse, pasi është përgatitur Raporti i Sigurisë, në ndërmarrje ekzistojnë ndryshime që mund të kenë pasoja të dukshme për parandalimin dhe zbutjen e aksidenteve madhore atëherë duhet të rishikohet Raporti i Sigurisë dhe çdo Raport Sigurie i rishikuar të dërgohet tek Autoriteti Kompetent.
4. Raporti i Sigurisë do të vendoset në regjistrin publik në rast se Autoriteti Kompetent nuk njoftohet me shkrim kur dorëzohet raporti që një pjesë e informacionit të mos bëhet publik. Të gjitha aplikimet për konfidencialitet duhet të përmbajnë informacion të mjaftueshëm për të mundësuar Autoritetin Kompetent që të marrë në konsideratë aplikimin siç duhet. Asnjë informacion nuk vendoset në regjistrin publik derisa të jenë përcaktuar të gjitha çështjet e konfidencialitetit. Regjistri publik mbahet nga Autoriteti Kompetent dhe rishikohet në baza pesë vjeçare.
5. Autoriteti Kompetent lexon Raportin e Sigurisë për të:
 - a. Ekzaminuar nëse informacioni është i mjaftueshëm;
 - b. Vlerësuar nëse janë përmbushur qëllimet për të cilat është përgatitur Raporti; dhe
 - c. Nxjerrë konkluzionet e tij për Raportin e Sigurisë.
6. Autoriteti Kompetent e përdor Raportin e Sigurisë për të:
 - a. Marrë veprime të menjëhershme ndaluese në rastet kur disa masa kanë mangësi serioze në parandalimin e aksidenteve madhore apo kufizimin e pasojave të tyre.
 - b. Vendosur se cilat instalime, pjesë të instalimeve apo aktiviteteve në ndërmarrje duhen përfshirë në programin e inspektimit.
7. Autoriteti Kompetent nxjerr konkluzione për Raportin e Sigurisë në bazë të gjykimit profesional. Konkluzionet bazohen në:
 - a. Nëse janë identifikuar mangësi serioze. Nëse po, Autoriteti Kompetent merr masa të menjëhershme. Masat ndaluese merren vetëm në rastin kur mangësitë serioze konfirmohen nga vizita në terren; dhe

- b. Nëse Raporti i Sigurisë, dhe çdo informacion shtesë i përfshirë gjatë vlerësimit, është i mjaftueshëm për qëllimet e tij.
8. Autoriteti Kompetent mund të kërkojë informacion shtesë nga operatori nëse nuk është dhënë informacion i mjaftueshëm në Raportin e Sigurisë që Autoriteti Kompetent të nxjerrë konkluzionet e veta. Megjithatë, nëse Raporti i Sigurisë, nuk ia arrin fare qëllimit të tij, operatorit mund t'i kthehet ky raport dhe t'i kërkojë që ta ridërgojë.
 9. Autoriteti Kompetent i dërgon operatorit konkluzionet e tij për Raportin e Sigurisë. Letra me konkluzionet vendoset në regjistrin publik.

2.2 Qëllimi i Raportit të Sigurisë

10. Qëllimet e Raportit të Sigurisë janë përcaktuar në Aneksin 3 Pjesa 1 e Ligjit.
11. Këto qëllime kërkojnë që operatori të demonstrojë që:
 - a. Janë vendosur Politika e Parandalimit të Aksidenteve Madhore (PPAM) dhe Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë (SMS) për zbatimin e saj;
 - b. Janë identifikuar aksidentet madhore;
 - c. Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet madhore dhe për të kufizuar pasojat për njerëzit dhe mjedisin;
 - d. Siguria dhe besueshmëria e duhur janë inkuorporuar tek projekt plani, ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e të gjitha instalimeve, impjanteve magazinuese, paisjeve dhe infrastrukturës që lidhen me rreziqet nga aksidentet madhore brenda ndërmarrjes; dhe
 - e. Është hartuar Plani i Brendshëm i Emergjencës.
12. Përveç kësaj, duhet gjithashtu që informacion i caktuar të përmbushë qëllimet e Raportit të Sigurisë. Ky informacion është:
 - a. Dërgimi i informacionit njësisë së qeverisjes vendore për të mundësuar hartimin e Planeve të Jashtme të Emergjencës; dhe
 - b. Dhënia e informacionit të mjaftueshëm Autoritetit Kompetent për ta mundësuar atë të japë këshilla për përcaktimin e aktiviteteve apo zhvillimeve të reja përreth ndërmarrjeve.
13. Seksioni 2.3, Përshkrimi i ndërmarrjes, përshkruan shkallën e informacionit të kërkuar që do të mundësojë Autoritetet Kompetente të kenë një pamje të qartë për ndërmarrjen, vendodhjen e saj, qëllimin, aktivitetet dhe rreziqet e trashëguara, shërbimet dhe paisjet teknike për parandalimin dhe kontrollin e aksidenteve madhore. Për territoret me shumë instalime, ky informacion shpesh përfshihet si pjesë e informacionit bazë të përbashkët për të gjithë ndërmarrjen. Informacion më i hollësishëm, siç është përshkrimi i paisjeve të kontrollit në lidhje me sigurinë, mund të jepet në përshkrimin e instalimeve individuale.

14. Seksioni 2.4, Informacioni rreth masave të menaxhimit për të parandaluar aksidentet madhore, detajon informacionin që pret të marrë Autoriteti Kompetent përsa i përket aspekteve organizative të menaxhimit për të parandaluar aksidentet madhore. Këto përbëjnë një pjesë thelbësore të sistemit të sigurisë në ndërmarrje. Në veçanti, do të jetë e nevojshme të shpjegohen veprimet se si operatori ka arritur tek masat e nevojshme për parandalimin apo kontrollin e aksidenteve madhore. Masat e dhëna dhe të përshkruara në Raportin e Sigurisë duhet të jenë të tilla që të demostrojnë që janë vënë në zbatim veprimet e përshkruara të menaxhimit. Për territoret me shumë instalime, të gjitha ndryshimet në veprime mund të identifikohen dhe përshkruhen në atë pjesë të raportit që flet për një instalim të veçantë.
15. Seksionet 2.5, 2.6 dhe 2.7 synojnë të bëjnë lidhjen midis rreziqeve të identifikuara në territory dhe masave të nevojshme për të parandaluar aksidentet madhore ose për të kufizuar pasojat e tyre.
16. Ekziston një rrjedhë e informacionit përkatës të duhur që trajton aktivitetet kryesore në territorin e ndërmarrjes dhe proceset që kryhen aty. Për këtë arsye, seksioni 2.5, informacion rreth aksidenteve të mundshme, duhet të diskutojë shkaqet kryesore të mundshme për aksidentet madhore dhe vlerësimin e pasojave. Seksioni 2.6, informacion rreth masave për parandalimin apo kufizimin e pasojave nga aksidentet madhore në secilin instalim, duhet të diskutojë masat për shmangien, parandalimin dhe kontrollin e aksidenteve madhore. Seksioni 2.7, informacion rreth masave të përgjigjes ndaj emergjencave për kufizimin e pasojave nga aksidentet madhore, do të diskutojë masat e dhëna për kufizimin e pasojave nga aksidentet madhore.
17. Masat e diskutuara mund të jenë masa inxhinjrike, sisteme dhe faktorë procedurialë apo humanë siç është trajnimi. Në shumicën e rasteve ka të ngjarë të jetë një kombinim i këtyre masave.
18. Gjetjet dhe konkluzionet nga analizat e riskut duhet të përmbledhin marrëdhënien midis rreziqeve dhe risqeve. Ato duhet të demostrojnë që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet madhore dhe kufizuar pasojat e tyre dhe që ka siguri dhe besueshmëri të mjaftueshme për instalimin, paisjet dhe infrastrukturën gjatë gjithë jetës së tyre.
19. Raporti i Sigurisë duhet të paraqesë lidhje të qarta midis:
 - a. Analizës së risqeve, përfshirë probabilitetin për të ndodhur ngjarje të rrezikshme dhe pasojat e tyre; dhe
 - b. Masave teknike dhe menaxheriale të marra.
20. Argumentat e paraqitura në Raportin e Sigurisë mund të jenë cilësore dhe të fokusohen në praktikën e mira përkatëse dhe parimet e shëndosha inxhinjrike. Ato mund të mbështeten gjithashtu në argumenta të përgjithshme për parandalimin e aksidenteve madhore apo kufizimin e pasojave të tyre bazuar në një grup përfaqësues skenarësh të aksidenteve madhore.

21. Situatat më tepër komplekse mund të kërkojnë prezantimin e argumentave sasiore të lidhur me analizën kosto fitim me qëllim që të justifikohen të gjitha masat e nevojshme që duhen marrë.
22. Në të gjitha rastet kur identifikohet që masat shtesë janë arsyeshëm praktike, këto masa duhen zbatuar. Justifikimi për të refuzuar masat për reduktimin e riskut të mundshëm duhet të argumentohet mirë dhe të mbështetet me fakte.
23. Gama e skenarëve të rrezikshëm të marrë në konsideratë duhet të jetë përfaqësuese dhe e përshtatshme për qëllimet e hartimit të planeve të emergjencës.
24. Duhet marrë në konsideratë skenarët në rastin më të keq për njerëzit dhe mjedisin. Analiza për këto nuk duhet të jetë tepër optimiste apo pesimiste pasi kjo gjë mund të shkaktojë implikime në burim për shërbimet e emergjencës. Prandaj, modelet e pasojave dhe hamendësimet e bëra duhet të jenë të përshtatshme për shkallën dhe natyrën e rreziqeve.
25. Nivelet e dëmeve të konsideruara dhe modelet e ekspozimit/kriteret e ndikimit të përdorura duhet të jenë të përshtatshme për parashikimin e shkallës së zonave ku njerëzit mund të lëndohen në mënyrë fatale apo serioze apo duhet të dërgohen në spital. Gjatë marrjes në konsideratë të ndikimeve në mjedis, nivelet korresponduese të dëmeve ndaj mjedisit duhen marrë parasysh.

2.3 Përshkrimi i ndërmarrjes

Informacioni për të lejuar komunikimin me Autoritetin Kompetent

26. Për t'i ardhur në ndihmë komunikimit midis operatorit dhe Autoritetit Kompetent kërkohet informacion bazë. Ky përfshin:
 - a. Emrin e operatorit të territorit;
 - b. Nëse operatori është kompani, adresën e zyrës së tij të regjistruar;
 - c. Emrin dhe adresën e ndërmarrjes, dhe nëse është e nevojshme, instalimin e mbuluar nga Raporti i Sigurisë;
 - d. Emrin, adresën, numrin e telefonit dhe faksit të personit të kontaktit brenda organizimit të operatorit për komunikimin në lidhje me Raportin e Sigurisë.
27. Gjithashtu mund të jetë e dobishme të përfshihet:
 - a. Adresa e emailit;
 - b. Referencat e hartës gjashtë shifrore që përcaktojnë vendodhjen e ndërmarrjes;
 - c. Detaje nëse operatori është pjesë e një grupi më të madh kompanish.

Informacion për substancat e rrezikshme

28. Raporti i Sigurisë duhet të japë hollësitë përkatëse për:

- a. Sasi të maksimale të substancave të rrezikshme aktualisht të pranishme apo që ka gjasa të jenë të pranishme në ndërmarrje ose instalim;
 - b. Emrat e substancave të rrezikshme;
 - c. Sjelljen e tyre fizike dhe kimike;
 - d. Dëmet e menjëhershme apo më të vonshme ndaj njerëzve dhe mjedisit
29. Shume informacion për kimikatet e rrezikshme mund të gjendet në Formularët e të Dhënave të Sigurisë, që mund të përdoren, kur është e mundur dhe e duhur.
30. Mbani mend që substancat e rrezikshme mund të gjenden si:
- a. Lëndë e parë, ndërmjetëse, nën-produkte, katalizatorë apo karburant;
 - b. Mbetje;
 - c. Konservantë dhe përbërës individualë; dhe
 - d. Substanca të prodhuara/formuara si rezultat i humbjes së kontrollit të proceseve kimike apo ngjarjeve të tjera të paplanifikuara, por të parashikueshme.
31. Raporti i Sigurisë duhet të përmbajë inventarin e të gjitha substancave të rrezikshme në apo mbi sasi të e pragut të nivelit më të ulët apo nivelit më të lartë. Substancat e rrezikshme nën këto sasi duhet të përfshihen gjithashtu, nëse janë të afta, drejtpërdrejt apo jo drejtpërdrejt të shkaktojnë aksident madhor. Duhet dhënë arsyet për mos përfshirjen e substancave të tjera të rrezikshme në territor nga Raporti i Sigurisë.
32. Gjate llogaritjes së inventareve maksimale, duhen marrë parasysh të gjitha ndryshimet në aktivitetin e biznesit.
33. Nëse ndërmarrja ka një numër të madh e të variueshëm substancash të ndryshme të rrezikshme, si në magazinë, këto mund të përshkruhen duke i grupuar në kategori përfaqësuese, në përputhje me Aneksin 1 Pjesa 3, kur përcaktohet sasia e tyre. Nëse bëhet një gjë e tillë, kjo duhet shpjeguar me justifikimet përkatëse për grupimet e zgjedhura.
34. Kur një numër substancash të ndryshme të rrezikshme janë të pranishme në sasi më të vogla se sa sasia kualifikuese e tyre, Raporti i Sigurisë duhet të tregojë se si janë mbledhur sasi të individuale në përputhje me rregullat në Rregullore.
35. Aneksi 1, Hyrje, paragrafi 4 i Ligjit lejon që të mos merren parasysh sasi të substancave të rrezikshme nën 2% të sasisë së tyre kualifikuese, për qëllime të llogaritjes së sasisë totale, por vetëm nëse mund të demonstrohet që ato nuk mund të jenë burim i aksidenteve madhore në vende të tjera në territor. Nëse përdoret kjo Pjesë e Ligjit, në Raportin e Sigurisë duhet të demonstrohet që substanca të tilla nuk mund të jenë burim i aksidenteve madhore në territor.
36. Për çdo substancë të rrezikshme apo kategori substancash të rrezikshme të identifikuar, përfshirë ato të pranishme si papastërti, konservantë apo përbërës të preparative, raporti i sigurisë duhet të përmbajë:
- a. Emrin e saj kimik, dhe ku duhet emrin e saj të përbashkët kimik;

- b. Identifikimin e substancës apo kategorisë së substancave sipas sistemit IUPAC të nomenklaturës;
 - c. Numrin CAS;
 - d. Shkallën e pastërtisë, nëse ka lidhje;
 - e. Përqendrimin e të gjitha papastërtive apo konservantëve dhe raportin e çdo përbërësi në preparat;
 - f. Çdo informacion tjetër të dobishëm shtesë që mund të ndihmojë në identifikimin e substancave të rrezikshme.
37. Duhet dhënë informacion për sjelljen fizike dhe kimike të substancave të rrezikshme të pranishme në ndërmarrje. Ky informacion duhet të detajojë ato veçori që kanë lidhje me demonstrimet e ndryshme të përmendura më tej në Raportin e Sigurisë.
38. Shembuj të informacionit që mund të përfshihet janë:
- a. Temperatura dhe trysnia karakteristike;
 - b. Përqendrimi dhe fazat në kushte normale në filluesën e kushteve jonormale;
 - c. Të dhënat e ekuilibrit, dhe kurbat e operimit, nëse kanë lidhje;
 - d. Pikën e ndezjes;
 - e. Temperaturën e shpërthimit;
 - f. Kufijtë e djegshmërisë;
 - g. Trysinë e avullit;
 - h. Dendësinë;
 - i. Të dhëna për reaksionet;
 - j. Përzieshmëria;
 - k. Koeficientët e ndarjes;
 - l. Normat e dekompozimit;
 - m. Të dhëna për ndjeshmërinë e lëndëve shpërthyese
 - n. Karakteristikat e korrozionit, aty ku ka lidhje.
39. Operatori duhet të marrë në konsideratë dhe të raportojë për sjelljen e substancave të rrezikshme sipas të gjitha kushteve normale të operimit, kushteve jonormale dhe kushteve të aksidenteve të parashikueshme. Për këtë arsye mund të jetë e nevojshme të raportohet nëse sjellja kimike e substancave të rrezikshme ndryshon përgjatë gamës së kushteve, që mund të përfshijnë për shembull:
- a. Trysni të dhe temperaturat e operimit gjatë fillimit, rigjenerimit, kushteve operuese normale, kohës së reduktimit të operimit apo mënyrave të tjera të përcaktuara;
 - b. Prodhimi i produkteve, nën-produkteve, mbetjeve apo ndërmjetësve si rezultat i operimeve normale apo në kushtet e aksidenteve të parashikueshme;
 - c. Sjellja e lëngjeve reaktorë gjatë dhe pas një problem në një proces;
 - d. Ndotja e produkteve.
40. Duhet dhënë informacion faktik në lidhje me karakteristikat e njohura fizike, kimike apo toksikologjike të substancave të rrezikshme në ndërmarrje, që mund të shkaktojnë dëme të menjëhershme apo të mëvonshme si për njerëzit ashtu edhe / ose për mjedisin. Informacioni duhet të përfshijë substance të

rrezikshme të formuara si rezultat i kushteve normale dhe jonormale. Gjithashtu duhet të jepet një tregues për rreziqet e paraqitura.

41. Është e nevojshme vetëm të paraqiten ato karakteristika që kanë lidhje me demostrimet e ndryshme të bërë më tej në Raportin e Sigurisë. Informacioni i dhënë duhet të adresojë si efektet afatshkurtra ashtu edhe ato afatgjata, dhe mund të përfshijë, për shembull:
 - a. Rreziqet nga shëndeti, siç janë irritimet, asfiksionet, vazhdimësia (zgjatja), efektet antagonistike dhe sinergjike, simptomat paralajmëruese, kanceri apo dëmtimet mutagjenike;
 - b. Përqendrimet vdekjeprurëse;
 - c. Dëmet e shkaktuara nga zjarri apo shpërthimi;
 - d. Efektet në mjedis, përfshirë dëmtimet në ndërtesa, ekosisteme dhe të gjitha speciet e ndjeshme përkatëse.
42. Informacioni i paraqitur duhet të marrë në konsideratë efektet e dëmshme për njerëzit dhe mjedisin dhe të konturojë rrugët e dmëveve, për shembull nëpërmjet shkarkimeve ajrore, shkarkimeve në ujë, depërtimeve në ujërat nëntokësore, formimit të reve shpërthyes.
43. Gjithashtu duhet të paraqiten kufijtë e pranueshëm të njohur të ekspozimit ndaj efekteve të substancave të rrezikshme, siç janë standartet LD50 dhe ato të cilësisë mjedisore. Mund të jetë e nevojshme të konsiderohen kufijtë e pranueshëm përsa i përket përqendrimeve, kohës së ekspozimit dhe parametra të tjerë përkatës.
44. Në rastet kur është e përshtatshme, i duhet bërë referencë literaturës shkencore për të justifikuar efektet e dëmshme, përqendrimet e rrezikshme dhe kufijtë e pranueshëm që janë paraqitur. Nëse ekziston pak njohuri shkencore për efektet, Raporti i Sigurisë duhet të nënvizojë përjasjen e ndjekur për të vlerësuar rëndësinë e mungesës së njohurive dhe politikave që kanë të bëjnë me të.

Informacion për mjedisin rrethues

45. Duhet dhënë informacion që përshkruan mjedisin rrethues të ndërmarrjes. Këtu përfshihet mjedisi natyror dhe njerëzit që jetojnë në të, mbi, nën dhe përreth kufijve të ndërmarrjes. Shkalla e zonës së përshkruar duhet të marrë parasysh gamën e rreziqeve apo skenarët e rastit më të keq të paraqitur më tej në Raportin e Sigurisë.
46. Mund të jetë e dobishme të përfshihet një hartë me shkallë të përshtatshme (p.sh. 1:10 000) që tregon ndërmarrjen dhe rrethinat e saj. Gjithashtu, mund të kërkohen harta të veçanta për të identifikuar popullsinë dhe mjedisin natyror përreth.
47. Hartat e siguruara duhet të tregojnë qartë:
 - a. Të gjitha modelet e përdorimit të tokës, për shembull, industrinë, bujqësinë, qendrat urbane dhe të gjitha zonat e ndjeshme mjedisore;

- b. Vendodhja e ndërtesave dhe infrastrukturës më të rëndësishme, për shembull, spitalet, shkollat, territoret e tjera industriale, autostradat dhe rrjetet hekurudhore, stacionet dhe stacionet hekurudhore seleksionuese, aeroportet, portet;
 - c. Pikat e nxjerrjes së ujit;
 - d. Sistemet e ujërave të zeza, pasi ato mund të shkarkojnë ndotës shumë kilometra larg territorit të aksidentit madhor.
48. Duhet të tregohen qartë rrugët e hyrjes në ndërmarrje si edhe rrugët e shpëtimit larg ndërmarrjes. Gjithashtu, duhet të tregohen të gjitha rrugët e tjera të trafikut të rëndësishme për operimet e shpëtimit dhe emergjencës. Mund të jetë e nevojshme të ketë harta me shkallë të ndryshme nëse duhen marrë në konsideratë efektet e distancës së gjatë.
49. Ka pesë aspekte të mjedisit rrethues që duhen konsideruar:
- a. Njerëzit;
 - b. Karakteristikat që kontribuojnë tek aksidenti madhor;
 - c. Mjedisi i ndërtuar;
 - d. Mjedisi natyror;
 - e. Të gjithë faktorët e jashtëm që mund të kontribuojnë tek aksidentet madhore.
50. Duhet të bëhet përshkrimi i popullsisë fqinje. Ky përshkrim mund të përfshijë për shembull:
- a. Numrin e përafërt të rezidentëve;
 - b. Numrat e përlogaritur të njerëzve që mund të vijnë në zonë si turistët, punonjësit në vendet e tjera të punës, etj;
 - c. Grupet e njerëzve që mund të jenë veçanërisht të ekspozuar ose për shkak të ndjeshmërisë së tyre ndaj rreziqeve në fjalë, si në spitale apo shkolla ose për shkak të dendësisë së popullsisë.
51. Duhet të jepet informacion i mjaftueshëm për të lejuar operatorin dhe Autoritetin Kompetent të vlerësojnë impaktin jo të drejtpërdrejtë të aksidentit madhor tek publiku, për shembull si rezultat i ndonjë kontaminimi të ujit të pijshëm.
52. Do të jetë e nevojshme të konsiderohen dhe përshkruhen të gjitha karakteristikat e mjedisit rrethues që mund të influencojnë ndikimin e aksidentit madhor. Këtu mund të përfshihen, për shembull:
- a. Topografia, nëse kjo mund të ketë efekt në përhapjen e çdo lloji gazi toksik apo të djegshëm. Këtu përfshihen ndërtesat dhe të gjitha strukturat nëntokësore siç janë nënkalimet këmbësore;
 - b. Rregjistrimet e motit lokal, përfshirë shpejtësinë dhe drejtimin e erës, rënien e shirave dhe lidhjen e këtij informacioni me sjelljen e shkarkimeve të substancave të rrezikshme;
 - c. Çdo gjeologji dhe hidrogeologji që ka lidhje;
 - d. Rrjedhat ujore përreth, shtresat ujëmbajtëse, pikat e nxjerrjes së ujit të pijshëm, nëse ka lidhje me shpërndarjen e ndotësve të lëngshëm apo kullësve;
 - e. Cilësia e ujit dhe tokës përreth;

- f. Sistemet e ujërave të zeza dhe ujërave të shiut;
 - g. Baticat dhe rrymat, sidomos nëse habitatet baticore apo të grykëderdhjeve gjenden në rrezik;
 - h. Të gjitha karakteristikat e mjedisit rrethues që mund të pengojë përgjigjen ndaj emergjencave apo masat ndaj ndotjes.
53. Gjithashtu, duhet të identifikohen, të gjitha territoret me rëndësi kulturore apo historike, nëse ato mund të jenë të ekspozuara ndaj efekteve të aksidenteve madhore.
54. Konsideratë i duhet dhënë çdo lloj infrastrukture, përfshirë rrugët apo shërbimet madhore të transportit, për shembull, elektriciteti, gazi, telefoni, kanalizimet e ujit dhe impiantet e trajtimit, nëse ato mund të jenë të ekspozuara ndaj efekteve të aksidenteve madhor.
55. Shkalla e zonës së përshkruar duhet të marrë parasysh gamat e rreziqeve për skenarët e rastit më të keq.
56. Mjedisi natyror rrethues duhet të përshkruhet me detaje të mjaftueshme për të mundësuar Autoritetin Kompetent të vlerësojë rëndësinë e ndikimit të aksidentit madhor.
57. Duhet të jepet një përshkrim i detajuar i pjesëve të ndjeshme të mjedisit.
58. Duhet shpjeguar rëndësia e karakteristikave të mjedisit natyror rrethues si në kontekst kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar, për shembull bimët dhe kafshët që janë veçanërisht në rrezik.
59. Duhet përfshirë informacion i mjaftueshëm për mjedisin rrethues që të mundësojë Autoritetin Kompetent të përcaktojë nëse janë përfshirë të gjitha influencat e jashtme tek aksidentet madhore. Mjedisi rrethues përfshin mjedisin natyror mbi, nën dhe përreth kufijve të ndërmarrjes.
60. Mjedisi fizik përreth ndërmarrjes mund të ketë ndikim tek ngjarjet që shkaktojnë aksidente të mundshme madhore. Në veçanti, i duhet dhënë konsideratë tërmeteve dhe rrëshqitjeve të mundshme që mund të shkaktojnë aksidente.
61. Gjithashtu, mund të konsiderohet informacioni historik për tokën në të cilën ndodhet ndërmarrja dhe rrethinat e saj. Gjithë historiku i aktiviteteve minerale apo bonifikimit të tokës që mund të çojë në rrëshqitje dhe duhet të përfshihet në Raportin e Sigurisë. Duhet marrë parasysh të gjitha përdorimet e mëparshme të tokës që mund të kenë lidhje dhe rëndësi për sa i përket tokës apo ujit të kontaminuar.
62. Mund të jetë e nevojshme gjithashtu të konsiderohen evidencat historike të ngjarjeve të tjera të jashtme që mund të shkaktojnë aksidente, ose që mund të çojnë në përkeqësimin e aksidentit. Për shembull, ngjarjet sizmike, përmbytjet dhe kushtet ekstreme të motit, si temperatura, shiu, bora.

63. Do të jetë e nevojshme të merren parasysh dhe të përshkruhen të gjitha aktivitetet e tjera në zonën përreth ndërmarrjes që mund të çojnë në aksident madhor apo përkeqësimin e tij. Për shembull:
- Ndërmarrje të tjera me rreziqe për aksidente madhore;
 - Tubacione;
 - Aktivitete aktuale minerare apo aktivitete të tjera nxjerrëse;
 - Lëvizjet e trafikut ajror mbi dhe rreth ndërmarrjes;
 - Aktivitetet e transportit që mund të kenë ndikim, si transporti i mallrave, rrugët madhore të transportit;
 - Aktivitete të tjera njerëzore që mund të çojnë në aksidente madhore si zjarrvënia e qëllimshme, vandalizmi, vjedhja dhe dëmtimet kriminale;
 - Tensioni i lartë mbi linjat e energjisë elektrike;
 - Direkët e transmetimeve me radio në zonë që mund të interferojnë në sistemet e kontrollit të sigurisë apo sistemet e komunikimit apo që mund të iniciojnë mjetet elektro-shpërthyes.

Pamje e përgjithshme e ndërmarrjes, aktiviteteve dhe produkteve të saj

64. Do të ishte e dobishme që Raporti i Sigurisë të japë një pamje të përgjithshme të ndërmarrjes, aktiviteteve dhe produkteve të saj. Pamja e përgjithshme është një skicë e përgjithshme pa detaje gjithëpërfshirëse për të përcaktuar kontekstin. Pamja e përgjithshme mund të përmbajë:
- Instalimet;
 - Skenarët e aksidenteve madhore;
 - Masat për mbrojtjen dhe parandalimin;
 - Ndër-marrëdhëniet midis instalimeve të ndryshme;
 - Zhvillimi historik i aktiviteteve dhe prodhimit.
65. Gjeografia e brendshme e ndërmarrjes si një e tërë duhet të përcaktohet preferueshëm nëpërmjet përfshirjes së planeve apo hartave të shkallëzuara plus përshkrimet. Informacioni duhet të përmbajë, për shembull:
- Vendodhja e instalimeve me potencial rreziku madhor;
 - Vendodhjet e instalimeve të tjera, përfshirë ato që nuk përmbajnë substanca të rrezikshme, me një skicë të aktiviteteve apo substancave të pranishme;
 - Vendodhja dhe numrat e personelit, etj. Këtu duhen marrë parasysh ndryshimet e parashikueshme tek numrat, si puna në turne, aktivitetet e mirëmbajtjes, kontraktorët, vizitorët;
 - Vendodhja e sistemeve kryesore të pezullimit/pakësimit;
 - Vendodhja e sistemeve të kontrollit kryesor, si sistemet e kontrollit të kompjuterit apo sistemet e izolimit;
 - Vendodhja e rrugëve, hekurudhave apo dokeve, hyrjeve në ndërmarrje;
 - Burimet dhe karakteristikat kryesore të shërbimeve thelbësore përfshirë sistemet e dublikimit/ tepicës;
 - Çështjet që lidhen me të gjitha përgjigjet ndaj emergjencave, si furnizimi me ujë kundër zjarrit, rrugët e shpëtimit dhe sistemet e komunikimit;
 - Sistemet për monitorimin dhe zbulimin e substancave toksike në ajër, ujër apo kanalizime;

- j. Sistemet për zbulimin e zjarreve dhe monitorimin e atmosferave potencialisht shpërthyes;
- k. Sistemet e sigurisë për monitorimin e aksesit dhe zbulimin e ndërhyrësve.

2.4 Informacion rreth masave menaxhuese për parandalimin e aksidenteve madhore

66. Ky kapitull jep udhëzime se si të prezantohet Politika e Parandalimit të Aksidenteve Madhore (PPAM) dhe informacion rreth Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë (SMS) për zbatimin e kësaj politike.
67. Disa prej informacioneve të dhëna këtu mund të mos kenë lidhje me ndërmarrjen. Megjithatë, Raporti i Sigurisë duhet të demonstrojë që PPAM dhe SMS janë të përshtatshëm në kontekstin e rreziqeve nga aksidentet madhore në territorin e ndërmarrjes.

Qëllimet e SMS dhe si merren parasysh të gjitha proceset e përmendura në Raportin e Sigurisë

Elementet e SMS

68. SMS është vetëm një pjesë e sistemit të përgjithshëm të menaxhimit në ndërmarrje, që nga ana tjetër mund të jetë pjesë e një sistemi menaxhimi për një kompani më të madhe apo grup kompanish. SMS mund të integrohet brenda sistemeve të tjera të menaxhimit në territory, si sistemi i menaxhimit të cilësisë. Për Raportin e Sigurisë, kjo duhet të ngushtohet në informacionin përkatës.
69. SMS e përshkruar në Raportin e Sigurisë duhet të trajtojë ato pjesë të veprimeve të përgjithshme të menaxhimit që lidhen me qëllimin dhe zbatimin e PPAM. Duhet të përshkruajë gjithashtu ato sisteme të menaxhimit të riskut që janë të rëndësishme për kontrollin e rreziqeve madhore.
70. Menaxhimi efektiv përfshin:
- a. pranimin e objektivave;
 - b. përcaktimin e planit për të arritur këto objektiva;
 - c. rëniën dakord për punën e detajuar për të zbatuar planin;
 - d. kontrollin e rezultateve sipas planit;
 - e. planifikimin dhe marrjen e masave të duhura korrektuese.
71. Veprimet e përgjithshme të menaxhimit mund të përfshijnë certifikimin e palës së tretë të pavarur si ISO 9001 për menaxhimin e cilësisë dhe/ose ISO14001 për menaxhimin e mjedisit. Nëse ka lidhje, këto duhet përmendur në Raportin e Sigurisë.

Qëllimi i përgjithshëm

72. Përsa i përket veprimeve të menaxhimit, qëllimi i përgjithshëm duhet të sigurojë që Raporti i Sigurisë:
- a. Përmban një PPAM;
 - b. Demonstron që ekziston një SMS për zbatimin e PPAM;
 - c. Demonstron që PPAM dhe SMS janë vënë në zbatim, duke marrë në konsideratë informacionin që përmbahen diku tjetër në Raportin e Sigurisë; dhe
 - d. Demonstron që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet madhore dhe për të kufizuar pasojat e tyre tek njerëzit dhe mjedisi.
73. Raporti i Sigurisë do të përfshijë gjithashtu përshkrimet e një sërë rezultatesh që edhe vetë përcaktohen ose influencohen nga SMS, si masat teknike paraprake. Ky informacion ndihmon të demonstrojë që PPAM dhe SMS janë vënë në zbatim.
74. Është e rëndësishme që jo thjesht të përmenden kualifikimet përkatëse të njerëzve këtu, por të tregohet që është vendosur një sistem për të siguruar dhe mirëmbajtur nivele të përshtatshme të menaxhimit dhe kompetencave të punonjësve.

PPAM

75. PPAM duhet të përfshijë:
- a. Një pohim që tregon angazhimin e kompanisë për të arritur standarte të larta të sigurisë dhe performancës mjedisore dhe një tregues që do të vihen në dispozicion burimet e nevojshme;
 - b. Një njohje që natyra e aktiviteteve në ndërmarrje shkakton rreziqe për aksidente madhore dhe për këtë arsye kompania ka detyrime ndaj punonjësve, fqinjëve dhe mjedisit;
 - c. Një fjali të qartë të politikës që shpjegon qëllimet e përgjithshme të kompanisë dhe parimet e veprimit në lidhje me kontrollin e aksidenteve madhore; dhe
 - d. Një angazhim për të siguruar dhe mirëmbajtur sistemin e menaxhimit që adreson çështjet e mëposhtme në kontekstin e ndërmarrjes;
 - i. Rolet dhe përgjegjësitë e atyre që përfshihen në menaxhimin e rreziqeve nga aksidentet madhore në të gjitha nivelet brenda organizatës,
 - ii. Veprimet për identifikimin sistematik të rreziqeve nga aksidentet madhore si rezultat i operimit normal dhe jonormal, dhe vlerësimi i probabilitetit dhe seriozitetit të tyre,
 - iii. Veprimet dhe procedurat për operim të sigurt, përfshirë mirëmbajtjen dhe ndalesat e përkohshme,
 - iv. Veprimet për planifikimin e modifikimeve për, ose projekt planin e, instalimeve të reja, proceseve apo impianteve magazinuese,
 - v. Veprimet për identifikimin e emergjencave të parashikueshme nga analizat sistematike, dhe për përgatitjen, testimin dhe rishikimin e planeve të emergjencës,

- vi. Veprimet për vlerësimin e vazhdueshëm të përputhjes me objektivat e përcaktuara në PPAM dhe SMS, përfshirë mekanizmat për investigimin dhe masat korrektuese në rastin e objektiveve që nuk përmbushen. Kjo duhet të përfshijë sistemin për raportimin e aksidenteve madhore dhe atyre që shmangen, dhe investigimin dhe ndjekjen e tyre në bazë të mësimave të nxjerra;
- vii. Veprimet për vlerësimin periodic dhe rishikimin e PPAM dhe SMS; dhe
- viii. Ofrimi i trajnimeve për të plotësuar nevojat e identifikuara për trajnim.

Organizimi

- 76. SMS duhet të reflektojë angazhimin nga lart poshtë, ndërgjegjësimin mjedisor dhe kulturën e sigurisë brenda dhe në ndërmarrje. Më tej duhet të përshkruajë se si kjo gjë përket në përgjegjësi direkte të njerëzve të përfshirë në menaxhimin e rreziqeve nga aksidentet madhore në të gjitha nivelet.
- 77. Duhet bërë një përshkrim për të treguar që rolet dhe përgjegjësitë për menaxhimin e rreziqeve nga aksidentet madhore janë alokuar siç duhet në nivelin e duhur brenda kompanisë.
- 78. Organigramat mund të përfshihen dobishëm.
- 79. Raporti i Sigurisë duhet të tregojë se si përgjegjësitë e gjithsecilit të përfshirë në menaxhimin e rreziqeve nga aksidentet madhore kanë qenë të përcaktuara qartësisht, në mënyrë që punonjësit dhe njerëzit e tjerë të përfshirë të dinë kush është përgjegjës për çdo aspekt përkatës. Megjithatë, nuk do të ishte e nevojshme të përfshihen kopje të përshkrimit të punës.
- 80. Raporti i Sigurisë duhet të tregojë se si kompania ka alokuar burime të mjaftueshme për të zbatuar PPAM. Kjo duhet të përfshijë shpjegime të shkurtër se si janë përcaktuar dhe alokuar burimet si ato njerëzore ashtu edhe ato financiare.
- 81. Duhet të jepen shpjegime se si janë gjetur burimet për sistemet e kontrollit të riskut kryesor dhe për veprimet e marra për plotësimin e posteve kryesore.
- 82. Duhet të ekzistojë një sistem për identifikimin e mungesave të personelit kryesor dhe për organizimin e zëvendësimit kompetent.
- 83. Menaxherët dhe punonjësit duhet të kenë njohuritë, aftësitë dhe eksperiencën e nevojshme që të jenë në gjendje të përmbushin përgjegjësitë e tyre për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore. Raporti i Sigurisë duhet të tregojë që njerëzit që kanë role kryesore në kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore janë kompetent në lidhje me përgjegjësitë e tyre.
- 84. Raporti i Sigurisë duhet të tregojë që kompania ka sisteme për përfshirjen e punonjësve në kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore.

85. Menaxherët e lartë nuk mund të menaxhojnë rreziqet nga aksidentet madhore vetë. Angazhimi, bashkepunimi dhe pjesëmarrja active e punonjësve në të gjitha nivelet janë thelbësore për suksesin. Do të ekzistojë nevoja që të përfitohet nga njohuritë dhe eksperiencia e punonjësve në të gjitha nivelet pasi ata mund të ndihmojnë në identifikimin e problemeve dhe ofrimin e zgjidhjeve.
86. Megjithatë, përfshirja e punonjësve nuk do të ndodhë në qoftë se kompania nuk ka një përjasje të strukturuar për të siguruar pjesëmarrjen e tyre.
87. Për këtë arsye, Raporti i Sigurisë duhet, për shembull:
- Të përmbledhë si kompania ka zhvilluar/është duke zhvilluar një kulturë që inkurajon pjesëmarrjen active të punonjësve;
 - Të shpjegojë si punonjësit janë përfshirë në trupa konsultativë, komitetet për shëndetin, sigurinë dhe mjedisin, etj;
 - Të përshkruajë si kompania inkurajon dhe mbështet punonjësit apo përfaqësuesit e sigurisë;
 - Të shpjegojë mekanizmat që kompania ka në dispozicion për të siguruar pjesëmarrjen e punonjësve ne rreziqet nga aksidentet madhore.
88. Raporti i Sigurisë duhet të theksojë veprimet për bashkëpunimin me, për shembull:
- Operatorët e ndërmarrjeve të tjera që mund të ndikohen nga rreziqet e aksidenteve madhore;
 - Shërbimet e emergjencës;
 - Njësitë e qeverisjes vendore me përgjegjësi për përgatitjen e Planit të Jashtëm të Emergjencës;
 - Autoriteti Kompetent.
89. Raporti i Sigurisë duhet të përshkruajë se si është siguruar që informacioni i rëndësishëm për sigurinë është përftuar dhe marrë parasysh – si ndryshimet në legjislacion, zhvillimi në standartet teknike dhe praktikat e menaxhimit dhe informacioni rreth incidenteve me potencial për aksidente madhore.
90. Raporti i Sigurisë duhet të shpjegojë veprimet në dispozicion për shpërndarjen e brendshme të informacionit të rëndësishëm për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore.
91. Raporti i Sigurisë duhet të shpjegojë veprimet për komunikimin e informacionit përkatës tek organizatat e jashtme. Në veçanti:
- Operatorët e ndërmarrjeve të tjera në zonë;
 - Shërbimet e emergjencës;
 - Njësitë e qeverisjes vendore me përgjegjësi për përgatitjen e Planeve të Jashtme të Emergjencës;
 - Autoritetin Kompetent;
 - Njerëzit në zonat fqinje që mund të preken nga aksidente madhore.

92. Duhet përshkruar veprimet për identifikimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, vlerësimin e risqeve dhe përcaktimin e masave që duhen për të kontrolluar risqet.
93. Gjithashtu duhet të përshkruhen procedurat për identifikimin e boshllëqeve dhe dobësive në veprimet e menaxhimit, sistemet e kontrollit të riskut kryesore dhe kontrollet fizike dhe masat paraprake në vendin e punës që janë të rëndësishme për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore.
94. Për këtë arsye duhen siguruar sisteme për të:
- a. Identifikuar rreziqet dhe vlerësuar risqet;
 - b. Identifikuar fushat për përmirësim;
 - c. Përzgjedhur përparësitë dhe programuar përmirësimet.
95. Menaxhimi i rreziqeve nga aksidentet madhore duhet të jetë një proces aktiv dhe i vazhdueshëm. Prandaj, veprimet për identifikimin sistematik të rreziqeve nga aksidentet madhore, vlerësimi i riskut dhe zgjedhja e masave të kontrollit janë thelbësore. Raporti i Sigurisë duhet, për shembull:
- a. T'i referohet procedurave për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve nga aksidentet madhore nga aktivitetet në ndërmarrje dhe nga substancat dhe materialet e blear, magazinuar, prodhuar apo përpunuara;
 - b. Të shpjegojë identifikimin e rreziqeve formale dhe teknikave të vlerësimit të riskut aktualisht të përdorura në çdo fazë të procesit apo ciklit të jetës së magazinimit. Në veçanti:
 - i. Përzgjedhja e territorit dhe përcaktimi i ndërtesave brenda ndërmarrjes,
 - ii. Impianti dhe planimetria e procesit dhe modifikimi,
 - iii. Ndërtimi, instalimi dhe testimi/akreditimi,
 - iv. Fillimi, operimi dhe mbyllja në kushte normale dhe jo normale,
 - v. Mirëmbajtja rutinë dhe jo rutinë,
 - vi. Incidentet dhe emergjencat e mundshme,
 - vii. Heqja nga puna dhe asgjësimi.
 - c. T'i referohet teknikave të përdorura për të identifikuar rreziqet dhe vlerësuar risqet që lindin nga faktorë të jashtëm;
 - d. Të përshkruajë se si veprimet për vlerësimin e riskut të marrin parasysh faktorët njerëz, përfshirë potencialin për gabim njerëzor;
 - e. Të përshkruajë se si rezultatet e identifikimit të rreziqeve dhe vlerësimit të riskut përdoren për të përcaktuar masat e kontrollit fizik dhe sistemet e kontrollit të riskut të nevojshme për parandalimin dhe kufizimin e aksidenteve madhore;
 - f. Të përshkruajë përjasjen e ndjekur për eliminimin e ngjarjeve të rrezikshme të mundshme në bazë të analizës së risqeve.
96. Raporti i Sigurisë duhet të shpjegojë sistemet e vendosura për të identifikuar fushat për përmirësim dhe se si janë planifikuar këto përmirësime.
97. Raporti i Sigurisë duhet të tregojë se si kompania ka ngritur sisteme për të vendosur përparësi për arrijen e objektivave të PPAM dhe për të planifikuar punët e nevojshme për përmirësim.

Sistemet e kontrollit të riskut kryesor

98. Ligji kërkon veçanërisht që SMS të adresojë tre sete kryesore të sistemeve të kontrollit të riskut:
- a. Kontrolli operacional;
 - b. Menaxhimi i ndryshimit; dhe
 - c. Planifikimi për emergjenca.
99. Këto mbulojnë një gamë të gjerë risqesh që diskutohen më poshtë. Jo të gjithë risqet mund të kenë lidhje me të gjitha ndërmarrjet. Megjithatë, gjatë ravijimit të këtyre sistemeve të kontrollit të riskut kryesor është e rëndësishme të përmendet se si punojnë këto sisteme dhe jo vetëm rezultatet e tyre.

Kontrolli operacional

100. Duhet bërë përshkrimet e sistemeve të kontrollit të riskut përkatës për çdo fazë të ciklit të jetës së impjantit, procesit apo impjanteve magazinuese. Kjo do të përfshijë sisteme për secilën nga fazat e mëposhtme:
- a. Ndërtimi dhe testimi/akreditimi i impjantit, proceseve, paisjeve dhe fasiliteve;
 - b. Operimi i impjantit dhe proceseve, përfshirë:
 - i. Vënien në punë,
 - ii. Funksionimin në gjendje të qëndrueshme,
 - iii. Mbyllja normale,
 - iv. Zbulimi i largimit nga kushtet operacionale normale dhe përgjigjet ndaj tyre, përfshirë mbylljet në rast emergjence dhe operimet special,
 - c. Operimi i sigurt nën kushtet e mirëmbajtjes, përfshirë:
 - i. Kryerja e vlerësimit të riskut për dekontaminimin dhe punimet e mirëmbajtjes,
 - ii. Krijimi i metodave të sigurta për punimet e mirëmbajtjes,
 - iii. Përzgjedhja dhe menaxhimi i kontraktorëve,
 - iv. Inspektimi, testimi dhe mirëmbajtja e impjantit, paisjeve dhe fasiliteve,
 - v. Heqja nga puna e impjantit, proceseve, paisjeve dhe fasiliteve.

Menaxhimi i ndryshimit

101. Raporti i Sigurisë duhet të tregojë që procedurat janë adoptuar dhe zbatuar për planifikimin e modifikimeve për ose projektimit të instalimeve, proceseve apo fasiliteve magazinuese të reja. Kjo duhet të përfshijë përshkrimet e:
- a. Sistemit për planifikimin dhe kontrollin e ndryshimeve tek:
 - i. Stafit dhe nivelet e marrjes së stafit,
 - ii. Impjanti,
 - iii. Proceset dhe ndryshoret e procesit,
 - iv. Materialet,
 - v. Paisjet,

- vi. Proçeset,
 - vii. Programi (software),
 - viii. Projekti
 - ix. Rrethanat e jashtme që janë të afta të ndikojnë në kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore.
- b. Koncepteve të përdorura për projektin e impjantit të ri apo proçesve të reja, duke shpjeguar se si;
- i. Janë alokuar përgjegjësitë për autorizimin dhe iniciimin e projektit të impjantit të ri,
 - ii. Janë identifikuar dhe dokumentuar projektet e propozuara për impjantin e ri,
 - iii. Janë identifikuar, vlerësuar dhe vendosur përparësitë e implikimeve për sigurinë dhe mjedisin nga impjanti i ri i propozuar,
 - iv. Janë përcaktuar, dokumentuar dhe zbatuar masat e kontrollit të mjedisit dhe sigurisë përfshirë dhënien e informacionit dhe trajnimeve dhe amendimin e proçedurave,
 - v. Janë kryer kontrollet dhe rishikimet pas-zbatimit dhe se si janë marrë masat korrektuese.
- c. Si menaxhimi i sistemit të ndryshimit mbulon ndryshimet e përhershme, të përkohshme dhe urgjente;
- d. Menaxhimit të sistemit të ndryshimit, që shpjegon se si:
- i. Janë marrë vendimet për atë çka konsiderohet “ndryshim i rëndësishëm”,
 - ii. Është përcaktuar ndryshimi,
 - iii. Janë alokuar përgjegjësitë për autorizimin dhe iniciimin e ndryshimit,
 - iv. Janë identifikuar dhe dokumentuar ndryshimet e propozuara,
 - v. Janë identifikuar, vlerësuar dhe përcaktuar përparësitë për implikimet në mjedis dhe siguri nga ndryshimet e propozuara,
 - vi. Janë përcaktuar, dokumentuar dhe zbatuar masat për kontrollin e sigurisë dhe mjedisit, përfshirë dhënien e informacionit dhe trajnimit dhe amendimin e proçedurave,
 - vii. Janë kryer kontrollet dhe rishikimet pas-zbatimit dhe se si janë marrë masat korrektuese.

Planifikimi për emergjenca

102. Çështjet e përshkruara këtu kanë gjithashtu lidhje me masat për përgjigje ndaj emergjencave (Kreu 7) dhe mund të përfshihen në atë pjesë të Raportit të Sigurisë.
103. Raporti i Sigurisë duhet të tregojë se si kompania ka kryer organizime për të identifikuar emergjencat e parashikueshme nëpërmjet analizave sistematike dhe që planet e brendshme të emergjencës janë përgatitur, testuar dhe rishikuar.
104. Raporti i Sigurisë duhet të përshkruajë proçedurat për:
- a. Identifikimin sistematik të pasojave të të gjitha aksidenteve madhore që mund të ndodhin;

- b. Përgatitjen, rishikimin, testimin dhe rifreskimin e Planeve të brendshme të Emergjencës në intervale të përshtatshme prej jo më shumë se tre vjetësh;
- c. Marrjen parasysh të sjelljes njerëzore të mundshme dhe përgjigjes nën kushtet e emergjencës, gjatë hartimit të planeve të emergjencës.

Matja e performancës

105. Proçedurat duhet të elaborohen, zbatohen dhe mirëmbahen për të siguruar që performance e sigurisë dhe mjedisit është monitoruar dhe krahasuar me objektivat e përcaktuara në PPAM dhe gjithë standartet e tjera. Këtu duhen përfshirë proçedurat për:
- a. Monitorimin aktiv – që përcakton nëse janë arritur planet dhe objektivat dhe nëse janë zbatuar veprimet për kontrollin e risqeve para se të ndodhë ndonjë incident apo aksident;
 - b. Monitorimi reaktiv – që raporton dhe investigon dështimet që kanë çuar në incidente apo pothuaj incidente.

Rishikimi dhe audit

106. Rishikimi është një proçes thelbësor për të përcaktuar nëse SMS është e përshtatshme të arrijë objektivat e PPAM. Mund të përfshijë marrjen në konsideratë nëse PPAM dhe objektivat e saj duhet të modifikohen ose nëse kërkohen përmirësime për sistemet e menaxhimit apo kontrollet fizike.
107. Raporti i Sigurisë duhet:
- a. Të tregojë që kompania ka adoptuar dhe zbatuar një proçes që përdor informacion nga matja e performancës dhe auditit;
 - b. Përshkruajë se si janë dokumentuar rezultatet e rishikimit;
 - c. Përshkruajë veprimet nëpërmjet të cilave janë përditësuar nga menaxhimi i lartë SMS dhe PPAM.
108. Auditimet kërkojnë të sigurojnë që proçeset dhe proçedurat, siç përcaktohen dhe kryhen në praktikë, janë konsistente me SMS dhe janë efektive. Auditimet duhet të drejtohen nga persona që janë mjaftueshëm të pavarur nga menaxhimi i operacioneve për të siguruar që vlerësimi i tyre është objektiv.
109. Raporti i Sigurisë duhet të tregojë që kompania ka adoptuar dhe zbatuar një proçedurë për vlerësimin e pavarur sistematik të PPAM si edhe efektivitetin dhe përshtatshmërinë e SMS.

2.5 Informacion për aksidentet e mundshme madhore

110. Kjo pjesë e Raportit të Sigurisë merret me:
- a. Përshkrimin e aktiviteteve kryesore në instalimet individuale dhe proçeset e ndërmarra aty;
 - b. Rreziqet nga aksidentet madhore – si identifikohen, pasojat e tyre dhe analiza e riskut.

Përshkrimi i proceseve, zonave në territory dhe skenarët që mund të çojnë në aksidente madhore.

111. Duhet të përshkruhet qëllimi i çdo instalimi që mund të shkaktojë aksidente madhore. Në rastet kur ka lidhje me aksidentet madhore, përshkrimi duhet të përfshijë:
 - a. Kushtet nën të cilat mbahen zakonisht substancat e rrezikshme;
 - b. Çfarë u ndodh substancave të rrezikshme përse i përket ndryshimeve fizike dhe kimike që shkaktohen nga qëllimi i përcaktuar i impjantit;
 - c. Çfarë u ndodh substancave të rrezikshme përse i përket ndryshimeve fizike dhe kimike që shkaktohen nga devijimet e parashikueshme nga qëllimi i përcaktuar i impjantit;
 - d. Shkarkimi, ruajtja, ripërdorimim riciklimi ose asgjësimi i mbetjeve, të lëngshme dhe të ngurta si edhe shkarkimi dhe trajtimi i mbetjeve të gazta.
112. Për secilin instalim duhet të jepet një pamje e përgjithshme që identifikon qartë vendodhjen përse i përket impjantit, aktiviteti ose të dyve bashkë, në rastin kur mund të ndodhë aksident madhor. Kjo duhet të përfshijë:
 - a. Diagramin e impjantit që identifikon qarëtësisht sistemet kryesore të kontrollit dhe sigurisë, enët e reaksionit, enët e depozitimit, sistemet e punës në tubacione, valvulat dhe lidhjet e rëndësishme;
 - b. Planin që identifikon qartë vendodhjen e aktiviteteve ku mund të ndodhë aksident madhor.
113. Skenarët e aksidenteve madhore duhet të përfshijnë ato të iniciuara nga ose që përfshijnë substance të rrezikshme në territor përfshirë ato që nuk formojnë pjesë të inventarit kualifikues për ndërmarrjen e Nivelit më të Lartë që kërkon Raport Sigurie.
114. Duhet marrë në konsideratë të gjithë skenarët e aksidenteve që shkaktohen nga substanca të rrezikshme. Vini re se nuk është e nevojshme që substanca e rrezikshme të shkaktojë aksident, por vetëm të ketë luajtur një pjesë në zinxhirin e ngjarjeve që kanë çuar në aksident.
115. Raporti i Sigurisë duhet të japë informacion për probabilitetet e pasojave të skenarëve të aksidenteve madhore apo të përmbledhë ngjarjet që mund të luajnë rol në iniciimin e skenarëve. Raporti duhet të përfshijë një vlerësim për shkallën dhe seriozitetin e të gjithë aksidenteve madhore të mundshme.
116. Vlerësimi i riskut përcakton nëse masat e marra janë të gjitha të nevojshme. Objekti dhe natyra e vlerësimit të riskut duhet të jenë të tilla që jenë të përshtatshme për qëllimin e tyre në lidhje me rrethanat në territor.
117. Ekziston një gamë përfaqësues për vlerësimin e riskut me ndërlikime në rritje, nga analizat e thjeshta cilësore përmes analizave gjysëm sasiore tek vlerësimi i riskut tërësisht sasior (i matshëm). Thellësia dhe tipi i analizave të riskut mund të variojë por duhet të jetë proporcionale me:
 - a. Shkallën dhe natyrën e rreziqeve nga aksidentet madhore në ndërmarrje dhe instalimet dhe aktivitetet aty;

- b. Risqet e imponuara nga territori i popullsisë dhe mjedisit fqinj, që do të thotë shkalla e dëmtimeve të mundshme; dhe
- c. Ndërlikimin e proceseve dhe aktiviteteve të rreziqeve nga aksidentet madhore dhe vështirësinë për të vendosur dhe justifikuar përshtatshmërinë e masave të adoptuara për kontrullin e riskut.

Përgatitja e informacionit për skenarët e aksidenteve madhore

118. Ekzistojnë tre hapa në përgatitjen e informacionit për të gjithë skenarët e aksidenteve madhore:
- a. Identifiko të gjitha aksidentet e mundshme madhore;
 - b. Jepni një vlerësim realist për mundshmërinë e të gjitha rreziqeve nga aksidentet madhore apo një përmbledhje të mjaftueshme për ngjarjet iniciuese;
 - c. Përgatisni një vlerësim të mjaftueshëm për shkallën dhe seriozitetin e pasojave për çdo rrezik madhor të identifikuar.

Hapi 1

119. Raporti i Sigurisë duhet të identifikojë gamën e plotë të aksidenteve madhore të mundshme dhe përshkruajë një komplet përfaqësues shembujsh, të mjaftueshme për të mundësuar një vlerësim gjithëpërfshirës për pasojat.
120. Kërkohet përjasje e strukturuar për identifikimin e rreziqeve. Raporti i Sigurisë duhet të përshkruajë procesin sistematik për të identifikuar të gjitha aksidentet madhore të parashikueshme.
121. Skenarët e aksidenteve madhore të paraqitura në Raportin e Sigurisë duhet të përfshijnë skenarët e rastit më të keq dhe ngjarjet e parashikueshme më serioze për njerëzit dhe mjedisin, duke marrë parasysh se çfarë mund të ndodhë si brenda ashtu edhe jashtë territorit.
122. Ekziston një numër metodash identifikuese për rreziqet. Këto përfshijnë:
- a. Studimet për rrezikun dhe operueshmërinë;
 - b. Rishikimet për sigurinë;
 - c. Studimet e shkaqeve të aksidenteve dhe incidenteve të mëparshme;
 - d. Standartet e industrisë;
 - e. Mënyrën e dështimit dhe analizën e efekteve;
 - f. Analizën e sigurisë në punë; dhe
 - g. Metodatat e identifikimit të gabimeve njerëzore.

Hapi 2

123. Raporti i Sigurisë duhet ose:
- a. Të përmbajë përlllogaritje të probabilitetit në terma cilësor apo sasior për çdo skenar aksidenti madhor; ose
 - b. Të përcaktojë kushtet nën të cilat mund të ndodhin skenarët e aksidentit madhor.
124. Cilido opsion të zgjidhet, Raporti i Sigurisë duhet të përfshijë një përmbledhje të ngjarjeve iniciuese dhe sekuencave të ngjarjes, të brendshme apo të jashtme, që mund të luajnë rol në shkaktimin e secilit skenar.

125. Raporti i Sigurisë duhet të shpjegojë procesin sistematik të përdorur për të identifikuar ngjarjet iniciuese dhe ngjarjen pasuese përfshirë, atje ku është e përshtatshme, informacionin e përfutur nga aksidentet dhe incidentet e mëparshme.
126. Gjatë marrjes në konsideratë të ngjarjeve që mund të çojnë në një aksident madhor, është e nevojshme të konsiderohet nëse një sekuencë apo kombinim ngjarjesh mund të çojë në një aksident madhor. Nëse po, do të jetë e nevojshme të vlerësohen efektet e dështimit në sistemet, impjantet dhe paisjet e projektuara për të zbuluar dhe parandaluar një skenar të tillë dhe të përshkruhen masat e marra për parandalimin e kësaj sekuence që ndodh.
127. Për sistemet e izolimit automatic, do të jetë e nevojshme të konsiderohet situatë kur sistemi dështon dhe operatori nuk arrin t'i përgjigjet siç duhet një alarmi. Do të jetë e nevojshme të vlerësohet nëse serioziteti i një rreziku dhe besueshmëria e sistemeve automatike dhe përgjigjes njerëzore janë të tilla që risku mbetet aq i vogël sa ç'është e praktikueshme llogjikisht.
128. Gabimi njerëzor duhet të konsiderohet si një ngjarje që inicion aksident, për shembull ngarkimi i reagentëve të gabuar në një reaktor parti, apo procedura operuese e gabuar që çon në një shkarkim jonormal në një rrjedhë ujore.
129. Të gjitha ngjarjet kritike të sigurisë dhe iniciatorët e lidhur me to duhet të identifikohen qartësisht. Ngjarjet kritike të sigurisë janë ato që dominojnë kontributin tek risku, kështu që ato duhet të identifikohen nëpërmjet analizës së riskut.
130. Ngjarjet kritike të sigurisë janë kyç për të identifikuar masat e përshtatshme të kontrollit dhe mbrojtjes me qëllim parandalimin e ngjarjeve të rrezikshme ose kufizimin e pasojave të tyre. Megjithatë, dështimi i këtyre masave mbrojtëse duhet të merret në konsideratë kur vlerësohet nëse risqet e mbetura janë aq të ulëta sa të praktikueshme llogjikisht apo nëse kërkohet të bëhet më shumë.
131. Nëse nuk pranohen masat potenciale të kontrollit, atëherë arsyet për të vepruar kështu duhet të jepen në Raportin e Sigurisë. Të gjitha hamendësimet apo përllogaritjet rreth besueshmërisë së sistemeve mbrojtëse dhe koha e kërkuar nga operatorët për t'iu përgjigjur dhe izoluar humbjen e kontrollit duhet të jetë realiste dhe e justifikuar në mënyrë të kënaqshme.
132. Argumentat cilësore duhet të bazohen në standartet e mira të pranuar aktualisht për rindërtimin e makinave (teknikat e konstruktimit) dhe sistemet e sigurta në punë. Informacioni duhet dhënë në Raportin e Sigurisë për të mbështetur të gjitha opinionet rreth kërkesës së mundshme për sistemet dhe masat e ndryshme të kontrollit si edhe cilat do të jenë pasojat në rast se ato dështojnë.
133. Për shembull, nëse një punëtor duhet të ndërhyjë për të mbyllur një valvul izolimi manualisht në rastin kur dështon izolimi automatic, atëherë kohëzgjatja do të përcaktohet nga koha e harxhuar për të ndërhyrë me sukses.

134. Të gjitha metodat e përdorura për të përcaktuar sekuencat e ngjarjeve dhe probabilitetet e aksidenteve të mundshme madhore duhet të jenë të përshtatshme dhe të përdoren korrektësisht.
135. Kjo duhet të përfshijë përdorimin e:
- Të dhënave përkatëse operacionale dhe historike;
 - Analizën e pemës së gabimeve;
 - Analizën e pemës së ngjarjeve; ose
 - Një kombinim të tyre.
136. Metodatat dhe hamendësimet e përdorura duhet të përshkruhen në Raportin e Sigurisë. Metodatat e përdorura duhet të jenë të përshtatshme për qëllimin dhe të përdoren siç duhet. Duhet bërë një përshkrim i procesit dhe metodave të adaptuara për të gjeneruar çdo probabilitet apo sekuencë ngjarjesh, së bashku me të gjitha hamendësimet dhe burimet e të dhënave të përdorura.

Hapi 3

137. Raporti i Sigurisë duhet të japë hollësi të mjaftueshme për të treguar që mënyra e vlerësimit të pasojave për çdo skenar aksidenti madhor në lidhje me njerëzit dhe mjedisin është i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm.
138. Duhet bërë përshkrimi apo referenca për çdo model vlerësimi pasojash dhe metodologji të përdorur. Duhet të ketë justifikime për hamendësimet e bëra dhe vlerat e përdorura në ndryshoret kryesore të metodës apo modelit, për shembull shpejtësia e erës, kushtet atmosferike, etj në modelet e shpërndarjes së gazit.
139. Gama e skenarëve të konsideruar duhet të jetë përfaqësuese dhe e përshtatshme për planifikimin e emergjencës.
140. Duhet konsideruar nivele të ndryshme dëmtimi. Minimalisht, duhet të konsiderohet se si një aksident madhor mund të ndikojë njerëzit dhe mjedisin. Duhet përcaktuar dhe justifikuar çdo kriter ndikimi apo model ekspozimi i përdorur, në parashikimin e shkallës së zonave në të cilat mund të ndikohen njerëzit apo mjedisi. Për të vlerësuar ndikimet mjedisore, duhet të merren në konsideratë shkatërrimet afatshkurtra dhe afatgjata të rikuperueshme dhe të pa rikuperueshme të gjallesave bimore dhe atyre shtazore.

2.6 Informacion rreth masave për parandalimin ose kufizimin e pasojave të aksidenteve madhore në çdo instalim.

Përshkrimi i instalimit, impjantit dhe paisjes

141. Raporti i Sigurisë duhet të përmbajë informacion për të gjitha instalimet që kanë potencial për aksident madhor. Për secilin instalim, duhet të ketë përshkrim me hollësi të mjaftueshme për të përcaktuar qëllimin, vendodhjen

dhe funksionin e paisjeve brenda instalimit që ka influencë në parandalimin dhe kontrollin e aksidentit madhor.

142. Qëllimi i informacionit është të japë detaje të mjaftueshme për Autoritetet Kompetente që të kuptojnë argumentat e drejtuara që janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për të parandaluar një aksidente madhor apo për të kufizuar pasojat e tij.
143. Ka mundësi që disa informacione të jepen më mirë nëpërmjet hartave, planeve apo diagramave me përshkrimet që përcaktojnë qartë informacionin e detajuar rreth instalimeve me aksidente madhore potenciale. Në veçanti, duhet të ketë informacion rreth pikave të impjantit që kanë lidhje me rreziqet nga aksidentet madhore në territor, siç janë:
 - a. Enët;
 - b. Sistemet e punës në tubacione;
 - c. Shërbimet, p.sh. avulli, ajri, energjia elektrike, karburatnit, uji i nxehtë;
 - d. Kullimi;
 - e. Kollonat, shkëndijat dhe pastruesit e gazit;
 - f. Valvulat e sigurisë kritike apo mjedisit kritik, qarqet e kontrollit dhe sistemet e zbulimit;
 - g. Pajset kundër zjarrit dhe veprimet e furnizmit; dhe
 - h. Paisjet monitoruese.
144. Do të jetë e nevojshme të përfshihet informacion për:
 - a. Parametrat operues normalë për impjantin;
 - b. Parametrat e projektuar për punë maksimale;
 - c. Informacion përkatës cilësor dhe sasior për energjinë dhe transportin e masës në proces gjatë;
 - i. Funksionimit normal,
 - ii. Periudhave të fillimit (vënies në punë) apo mbylljes (stakimit), dhe
 - iii. Operacioneve jo normale.
 - d. Vendodhjet e substancave të rrezikshme dhe tek çdo vendodhje – informacion për gjendjen kimike dhe fizike dhe sasinë e substancës së rrezikshme.

Përshkruani se si masat e marra do të parandalojnë ose kufizojnë pasojat e aksidentit madhor

145. Raporti i Sigurisë duhet të demostrojë si masat e marra do të parandalojnë dështimet e parashikueshme që mund të çonin në aksidentet madhore të identifikuar. Ai duhet të tregojë si kontribuon çdo masë në mbrojtjen ndaj secilës ngjarje të rrezikshme. Kur ngjarjet përfaqësuese janë zgjedhur, masat mund të lidhen me një gamë të gjerë ngjarjesh me rezultate të njëjta.
146. Raporti i Sigurisë duhet të tregojë se si do të aplikohet përqasja e ndjekur tek impjantet e reja dhe të modifikuara që janë duke u instaluar dhe çfarë procedurash ekzistojnë për të aplikuar përqasjen kur projektohen impjante të reja apo modifikime në impjantet e ekzistuese.

147. Raporti i Sigurisë duhet të demostrojë gjithashtu se sa mjaftueshëm janë integruar siguria dhe besueshmëria në të gjitha masat për parandalimin ose kufizimin e pasojave të një aksidenti madhor gjatë ciklit të plotë të jetës të çdo instalimi.
148. Për ndërmarrjet ekzistuese, masat duhet të jenë përcaktuar tashmë. Në këto raste Autoriteti Kompetent do të jetë më pak i preokupuar se si janë përzgjedhur këto masa në të kaluarën, por më shumë i preokupuar në përshkrimin se çfarë janë ato dhe cili është qëllimi i tyre. Autoriteti Kompetent do të dojë të dijë që masat e përzgjedhura dhe të përdorura kanë sigurinë dhe besueshmërinë e nevojshme për parandalimin e aksidenteve madhore apo kufizimin e pasojave të tyre.
149. Masat mund të marrin formën e sistemeve hardware, software apo faktorëve njerëzorë. Është e rëndësishme që performanca e specifikuar për masat e reduktimit të riskut të jetë e lidhur me skenare realiste.

Përzgjedhja e masave

150. Faza e projektit fillestar përfaqëson mundësinë më të mirë për të larguar rreziqet dhe reduktuar riskun. Kjo mundësi gjithashtu mund të shfrytëzohet në projektin e modifikimeve. Për këtë arsye operatorët e ndërmarrjeve më të vjetra duhet të jenë të ndërgjegjshëm për avancimet teknike në industrinë e tyre për të përmirësuar sigurinë.
151. Masat e marra për të parandaluar apo kufizuar pasojat e aksidenteve madhore mund të kategorizohen në katër nivele:
- Niveli 1 – siguri e trashëguar (e lindur)
 - Niveli 2 – masat e parandalimit
 - Niveli 3 – masat e kontrollit
 - Niveli 4 – masat e kufizimit.
152. Niveli 1 – siguria e trashëguar (e lindur) lidhet me heqjen apo reduktimin e rreziqeve në burim. Shembujt e teknikave të sigurta të trashëguara përfshijnë:
- Zëvendësimi i procesit më pak të rrezikshëm;
 - Përdorimi i materialeve rezistente ndaj gërryerjes;
 - Reduktimi apo eliminimi i inventarit të rrezikshëm;
 - Projekti për kushtet operuese maksimale të parashikueshme; dhe
 - Parimet e projektit të sigurt ndaj dështimeve dhe planimetria e përshtatshme e impjantit.
153. Niveli 2 – masat e parandalimit synojnë të parandalojnë iniciimin e sekuencës së ngjarjeve që mund të çojnë në aksident madhor. Ato mund:
- Të jenë sisteme menaxhimi apo karakteristika të projektit të instalimit;
 - Të aplikohen gjatë projektit, ndërtimit, operimit, mirëmbajtjes dhe modifikimit;
 - Të jenë të projektuara për të parandaluar dështimin e paisjeve apo gabimit njerëzor dhe përfshijnë aktivitete individuale, që do të thotë

mirëmbajtje apo inspektim, synuar në parandalimin e dështimeve specifike;

- d. Përfshijnë veprime për hardware-ët siç janë tubat me mure të dyfishta për të siguruar kontroll dytësor.

154. Niveli 3 – masat e kontrollit synojnë të parandalojnë një ngjarje të rrezikshme nga përshkallëzimi i saj në një aksident madhor. Ato përfshijnë masa të drejtuara në parandalimin apo kufizimin e shkarkimeve të të vogla që kanë potencial për to përshpejtuar në aksident madhor. Masat e kontrollit duhet të jenë të pavarura nga shkaku i inicimit të ngjarjes së rrezikshme dhe sistemeve të lidhura me të, në mënyrë që të mos dështojnë si rezultat direkt i ngjarjes. Masat e kontrollit mund të përfshijnë, për shembull:

- a. Valvulat liruese;
- b. Sistemet e kontrollit të lidhura me sigurinë;
- c. Sistemet e vërshimeve (përmbytjeve);
- d. Ventilimi tek sistemet e shpëlarjes së gazit apo kollonave të gazit;
- e. Proçedurat e mbylljes manuale në rast emergjence;
- f. Sistemet e zbulimit të gazit.

155. Niveli 4 – masat e kufizimit janë masat e marra për reduktimin e pasojave për të reduktuar pasojat e aksidentit madhor pasi ka ndodhur. Masat e kufizimit mund të përfshijnë, për shembull:

- a. Strehimet e sigurta;
- b. Sistemet shmangies së përmbytjeve për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore dhe tokësore;
- c. Impjantet kundër zjarrit;
- d. Proçedurat e përgjigjes së emergjencave;
- e. Traversat ose pirgjet për ndërtesat shpërthyes.

Përshkruani se sa mjaftueshëm janë integruar në instalim siguria dhe besueshmëria

156. Ekzistojnë pesë elemente që duhen konsideruar kur demonstron që siguria dhe besueshmëria janë integruar në instalim. Këto janë:

- a. Projekti – përfshin skicën, projektin e proçesit dhe projektin e paisjeve. Vini re diskutimi për projektin conceptual është i rëndësishëm për tani apo instalimet e modifikuara;
- b. Ndërtimi – përfshin prodhimin, instalimin, ndërtimin e strukturave, testimin, inspektimin fillestar dhe testimin/akreditimin;
- c. Operimi – përfshin vënien në punë të impjantit, mbylljen, operimin normal, përfshirë operimet e përkohshme të parashikueshme, mbylljet në rast emergjence dhe shkallën në të cilën do të tolerohej devijimi nga operimi normal;
- d. Mirëmbajtja – përfshin mirëmbajtjen parandaluese, riparimin, zëvendësimin, ekzaminimin periodik nga një person kompetent dhe vlerësimin e çdo difekti të gjetur;
- e. Modifikimi – përfshin masat që kanë të bëjnë me ndryshimet që mund të ndodhin në instalim gjatë jetës së tij, përfshirë të gjitha variacionet, dhe gjatë heqjes nga puna, që mund të ndikojnë në integritetin e instalimit të mbetur.

157. Raporti i Sigurisë duhet të tregojë si janë projektuar ndërmarrja dhe instalimet ndaj standartit të përshtatshëm. Kjo është veçanërisht thelbësore për raportet tek instalimet e reja ose të modifikuara. Për impjantet më të vjetra, raporti duhet të bëjë të qartë çfarë (nëse ekziston ndonjë) sistemesh apo veprimesh shtesë janë vendosur për të parandaluar ose kufizuar pasojat e aksidentit madhor, për të marrë parasysh të gjitha impjantet ose paisjet që janë ndërtuar sipas standarteve që nuk janë më fuqi ose që janë prezantuar si rezultat i eksperiencave të gjata operationale në territor.
158. Duhet të bëhet një përshkrim i qartë i përjasjes së ndjekur për përzgjedhjen e masave si pjesë e sistemit për projektimin e impjantit. Të gjitha standartet e projektit duhet të nxjerrin në pah çështjet kryesore:
- Humbja e punës (papunësia), diversiteti, veçimi dhe ndarja;
 - Ndikimi i një ngjarjeje të vetme që mund të ketë efekte të shumëfishta;
 - Planimetria e impjantit;
 - Besueshmëria, disponueshmëria dhe aftësia për mbijetesë e shërbimeve;
 - Kontrolli;
 - Integriteti strukturor;
 - Mbrojtja ndaj tepricave përtej kushteve të projektit;
 - Sistemet e kontrollit në lidhje me sigurinë;
 - Faktorët njerëzorë; dhe
 - Sistemet për identifikimin e vendodhjeve ku mund të jenë të pranishme substancat e djegshme.
159. Raporti i Sigurisë duhet të tregojë që instalimet janë ndërtuar sipas standarteve të përshtatshme për të shmangur aksidentet madhore dhe kufizuar pasojat e tyre.
160. Ai duhet të tregojë gjithashtu që prodhimi dhe ndërtimi i impjantit kanë aplikuar materiale dhe metoda ndërtimi të përshtatshme për të minimizuar ndodhjen e difekteve ose dëmtimit që mund të ndikojë integritetin e impjantit. Duhet të jepet referencë për të gjitha kodet apo standartet e ndërtimit që janë përdorur.
161. Raporti i Sigurisë duhet të tregojë që procedurat e sigurta të operimit janë ngritur dhe dokumentuar për të gjitha kushtet e parashikueshme me llogjikë, përfshirë vënien në punë, mbylljen dhe kushtet operuese jo normale, dhe në veçanti për qëllimet kritike të sigurisë.
162. Raporti i Sigurisë duhet të identifikojë se si janë ndërmarrë dhe regjistruar rishikimet e procedurave, për të marrë parasysh eksperiencën operationale apo kushtet në ndryshim në impjant.
163. Raporti i Sigurisë duhet të tregojë që është hartuar një skemë mirëmbajtje e përshtatshme për impjantet dhe sistemet, për të parandaluar aksidentet madhore apo kufizuar pasojat e tyre. Procedurat e mirëmbajtjes duhet të jenë mjaftueshëm gjithëpërfshirëse për ta mbajtur impjantin dhe paisjet në gjendje të sigurt.

164. Gjithashtu duhet të tregohet që aktivitetet e mirëmbajtjes nuk do të kompromentojnë sigurinë e instalimit dhe që stafi i mirëmbajtjes nuk do të ekspozohet ndaj risqeve të papranueshme.
165. Raporti i Sigurisë duhet të përshkruajë organizimin e aktiviteteve të mirëmbajtjes. Në veçanti, ai duhet të përfshijë informacion për:
- Sistemet e raportimit të gabimeve;
 - Disponueshmërinë dhe vënien në punë të stafit dhe paisjeve të përshtatshme; dhe
 - Programimi dhe renditja e aktiviteteve rutinë të mirëmbajtjes.
166. Raporti i Sigurisë duhet të identifikojë ato pjesë të impjantit dhe sistemeve për të cilat mirëmbajtja konsiderohet si aktivitet kritik për sigurinë.
167. Raporti i Sigurisë duhet të tregojë që ndikimi i punës së mirëmbajtjes për sigurinë e instalimit është marrë në konsideratë në mënyrë të përshtatshme. Gjithashtu duhet të tregojë që janë vendosur procedurat dhe paisjet për të garantuar që impjanti është i sigurt përpara fillimit të punës së mirëmbajtjes dhe për ri-fillimin e impjantit në gjendjen operuese pasi është kryer mirëmbajtja.
168. Duhet identifikuar procedurat e nevojshme për të mundësuar që puna e mirëmbajtjes do të kryhet në mënyrë të sigurt. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për aktivitetet që mund të rezultojnë në situata të rrezikshme. Informacioni i dhënë mund të lidhet me, për shembull;
- Rreziqet e shkaktuara nga paisjet elektrike dhe procedurat për sigurimin;
 - Rreziqet e lidhura me ‘punën e nxehtë’, dhe procedurat për vlerësimin e riskut ose testimin e gazrave të djegshme; dhe
 - Rreziqet e lidhura me shërbimet nëntokësore dhe procedurat për mbajtjen të informuar kontraktorëve rreth këtyre shërbimeve në zonat ku ata punojnë.
169. Raporti i Sigurisë duhet të identifikojë se cilat aktivitete i nënshtrohen sistemit të ‘lejes për punë’ dhe përshkruajnë karakteristikat kryesore të sistemeve të vendosura në ndërmarrje.
170. Raporti i Sigurisë duhet të tregojë që sistemet e vendosura sigurojnë që impjantet dhe sistemet kritike të sigurisë janë ekzaminuar në intervale të përshtatshme nga një person kompetent.
171. Raporti i Sigurisë duhet të identifikojë të gjitha impjantet apo sistemet kritike të sigurisë që dihet se janë të prirura ndaj defekteve, që janë riparuar apo që kanë histori dështimesh. Në raste të tilla, duhet të jepet evidencë shtesë për të treguar monitorimin e duhur të situatës dhe detajet e çdo programi zëvendësimi.
172. Raporti i Sigurisë duhet të përshkruajë sistemet e vendosura për të siguruar që modifikimet janë konceptuar, projektuar, instaluar dhe testuar siç duhet.

173. Modifikimet e proçeseve dhe paisjeve të lidhura me to, dhe strukturat (përfshirë magazinat), ose operacionet dhe proçedurat, që mund të ndikojnë sigurinë e instalimit normalisht duhet t'i nënshtrohen sistemit formal të modifikimit. Këtu përfshihen si masat për hardware ashtu edhe ato për software.
174. Gjatë kohës së jetës së një instalimi, mund të ketë raste që kërkojnë heqjen nga puna dhe largimin e impjantit ose pjesë të tij përbërëse, për shembull si pjesë e një programi modifikimi ose si pjesë e reduktimit të riskut nëpërmjet largimit të impjantit të hequr nga puna.
175. Raporti i Sigurisë duhet të identifikojë impjantin madhor të hequr nga puna dhe marrëdhënien e tij me sistemet dhe impjantin e mbetur përkatës. Largimi i një impjanti të tillë nuk duhet të çojë në risk të rritur lidhur me përdorimin e sistemeve dhe impjantit të mbetur.
176. Kujdes i veçantë duhet treguar për të siguruar integritetin e sistemeve të mbetura të sigurisë pas largimit të impjantit dhe veprime të tilla duhet të përfshihen në përshkrimin e 'sistemit të ndryshimit'. Këtu mund të përfshihet sigurimi që, për shembull:
- Seksionet e sistemeve të mbrojtjes nga zjarri nuk janë kompromentuar nga izolimi fizik pas largimit të seksioneve të hequra nga puna të sistemit të furnizimit me ujë kundër zjarrit;
 - Sistemet e mbylljes nuk janë kompromentuar nga ndryshimet logjike të software-it të kompjuterit;
 - Nivelet e mbrojtjes së paisjeve nuk janë reduktuar nëpërmjet heqjes nga puna të disa instrumentave apo shërbimeve, etj.

2.7 Informacion për masat e përgjigjes ndaj emergjencës për të kufizuar pasojat e aksidenteve madhore

177. Ky seksion trajton informacionin që duhet dhënë në Raportin e Sigurisë për gamën e masave të emergjencës që janë vendosur për t'iu përgjigjur rreziqeve nga aksidentet madhore. Kjo përfshin burimet që mund të mobilizohen siç janë paisjet kundër zjarrit dhe kërkesat për restaurim dhe pastrim.
178. Operimi i hollësishëm i masave të përgjigjes ndaj emergjencave do të përfshihen në Planin e Brendshëm të Emergjencës për ndërmarrjen. Plani i Brendshëm i Emergjencës nuk duhet të përfshihet në Raportin e Sigurisë – megjithatë Raporti i Sigurisë duhet të japë informacion për pikat kryesore përfshirë informacionin minimal të kërkuar nga Ligji.
179. Qëllimi këtu në Raportin e Sigurisë duhet të demonstrojë që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të kufizuar pasojat e aksidentit madhor dhe që është hartuar Plani i Brendshëm i Emergjencës për t'i marrë këto parasysh. Masat duhet të jenë të lidhura, dhe preferueshëm të ndër-referuara, me skenarët e aksidenteve madhore të përshkruara diku tjetër në Raportin e Sigurisë.

180. Seksioni 2.4 merret me sistemet e kontrollit të riskut. Organizimi i alarmit dhe ndërhyrja në rast emergjence formon sistemin të menaxhimit të sigurisë dhe mund të ndjekë modelin e menaxhimit të përshkruar këtu.

Përmbledhja e masave të mbrojtjes dhe ndërhyrjes që mund të jenë përdorur në përgatitjen e Planit të Brendshëm të Emergjencës

181. Raporti i Sigurisë duhet të përmbledhë masat për mbrojtjen dhe ndërhyrjen që janë përdorur si bazë për hartimin e Planit të Brendshëm të Emergjencës. Në veçanti, Raporti duhet të trajtojë:
- a. Paisjet e instaluar në impjant për të kufizuar pasojat e aksidentit madhor;
 - b. Organizimi i alarmit dhe ndërhyrjes; dhe
 - c. Burimet që mund të mobilizohen brenda dhe jashtë territorit.
182. Do të lind nevoja t'u referohet paisjeve fikse të instaluar në impjant që kufizojnë pasojat e aksidenteve madhore dhe si këto paisje ndikojnë mënyrën si zotërohet një emergjencë, për shembull veprimet për mbylljen në rast emergjence përfshirë shkallën e kërkuar të ndërveprimit manual. Përshkrimi i paisjeve të tilla dhe projekti i tyre dhe mirëmbajtja do të përfshihen në informacionin e përshkruar në seksionin 2.6.
183. Raporti i Sigurisë duhet të përshkruajë organizimin e alarmit dhe ndërhyrjes në rast aksidenti madhor. Duhet të përfshihen sa më poshtë vijojnë, nëse kanë lidhje me skenarët e aksidenteve madhore në territor:
- a. Funkcionet e pozicioneve kyçe dhe grupet me detyrat e lidhura me përgjigjen ndaj emergjencave dhe veprimet për të gjithë zëvendësuesit e tyre;
 - b. Veprimet për kontrollin dhe kufizimin e përshpejtimit të aksidenteve në territor;
 - c. Veprimet për dhënien e alarmit individëve në territor, ndërmarrjeve fqinje, kur kanë lidhje, dhe publikut të gjerë për:
 - i. Situatën e rrezikshme,
 - ii. Natyrën e alarmeve dhe kushtet e impjantit që kërkohen për t'i aktivizuar ato, dhe
 - iii. Veprimet fillestare të kërkuara si brenda territorit ashtu edhe jashtë tij në përgjigje të alarmeve dhe paralajmërimeve;
 - d. Kërkesat për krijimin dhe mbajtjen e komunikimeve gjatë përgjigjes ndaj emergjencave;
 - e. Natyra e, dhe veprimet për mbajtjen, të gjitha marrëveshjeve të ndihmës reciproke me ndërmarrjet fqinje, për shembull, dhënia e paisjeve dhe burimeve njerëzore, ndihmës së parë dhe shërbime të specializuara mjekësore;
 - f. Veprimet dhe kushtet për dhënien e alarmit dhe mobilizimit të:
 - i. Individëve apo grupeve me përgjegjësi të përcaktuara sipas planeve të emergjencës, përfshirë personelin thelbësor si brenda ashtu edhe jashtë territorit,
 - ii. Shërbimet e emergjencës,

- iii. Ndërmarrjet fqinje, nëse ekzistojnë marrëveshje për ndihmë reciproke;
- g. Natyra dhe vendodhja e të gjitha instalimeve që mund të kërkojnë mbrojtje speciale apo ndërhyrje shpëtimi;
- h. Natyra dhe vendodhja e;
 - i. Qendrave të kontrollit të emergjencës,
 - ii. Qendrave mjekësore dhe të ndihmës së shpejtë,
 - iii. Strehimet e emergjencës,
 - iv. Ndërtesave strehuese,
 - v. Pikave të grumbullimit,
 - vi. Pikave të paracaktuara të kontrollit të avancuar, dhe
 - vii. Çdo informacioni tjetër përkatës;
- i. Vendodhja e rrugëve të hyrjes për shërbimet e emergjencës, rrugëve të shpëtimit dhe gjithë zonave të kufizuara;
- j. Veprimet për evakuim dhe gjithë kërkesat e transportit;
- k. Veprimet për t'u siguruar që gjithë personeli është evakuar nga ndërtesat;
- l. Të gjitha veprimet për kërkim dhe shpëtim;
- m. Natyra dhe vendodhja e të gjitha materialeve dhe mjeteve të kontrollit të ndotjes dhe veprimet për të gjitha pastrimet dhe restaurimet vijuese të mjedisit;
- n. Veprimet për territoret pa personel dhe ato ku nivelet e personelit variojnë në kohë të ndryshme;
- o. Marrja në konsideratë e efekteve të veprimeve për përgjigje ndaj emergjencës, përfshirë aktivitetet kundër zjarrit, për të minimizuar ndikimin e përgjithshëm tek njerëzit dhe mjedisi. Kjo duhet të përfshijë si efektet afatshkurtra ashtu edhe ato afatgjata dhe të gjitha opsionet alternative për asgjësimin apo shkarkimin e kimikateve të shkarkuara; dhe
- p. Kur ka lidhje, kërkesat që janë hartuar për monitorimin e shpejtësisë dhe drejtimit të erës dhe të gjitha kushtet e tjera mjedisore.

184. Raporti i Sigurisë duhet të përshkruajë burimet brenda dhe jashtë territorit që janë të disponueshme për mobilizim në rastin e një aksidenti madhor. Kjo duhet të demonstronë që ekzistojnë burime të nevojshme për të kontribuar në masat e përgjithshme të nevojshme për të kufizuar pasojat e një aksidenti madhor.

185. Prandaj, Raporti i Sigurisë duhet të përfshijë burime të disponueshme:

- a. Që gjenden në territor;
- b. Që ofrohen nga shërbimet e emergjencës;
- c. Që gjenden në ndërmarrjet fqinje me të cilat janë bërë marrëveshje për ndihmë reciproke; dhe
- d. Që mund të sillen nga operatori nga diku tjetër.

186. Raporti i Sigurisë duhet të shpjegojë gjithashtu se si përgjigja brenda territorit do të plotësojë, dhe do të kordinohet me, rolin e shërbimeve të emergjencës jashtë territorit. Ky informacion duhet të përfshijë detaje, kur është e përshtatshme, të:

- a. Burimeve njerëzore;

- b. Hardware-it;
- c. Paisjeve personale mbrojtëse;
- d. Paisjeve kundër zjarrit dhe paisjeve zjarr mbrojtëse;
- e. Masave dhe sistemeve për të minimizuar shkarkimin, dhe për të kufizuar pasojat, e substancave të rrezikshme në ajër;
- f. Masave dhe sistemeve për të minimizuar shkarkimin, dhe për të kufizuar pasojat, e substancave të rrezikshme në ujë;
- g. Masave dhe sistemeve për të minimizuar shkarkimin, dhe për të kufizuar pasojat, e substancave të rrezikshme në tokë;
- h. Monitorimit dhe marrjes së kampioneve;
- i. Kërkesave për restaurim dhe pastrim;
- j. Ndihmës së parë dhe trajtim mjekësor; dhe
- k. Çdo paisje mbrojtëse.

187. Raporti i Sigurisë duhet të tregojë që janë ndërmarrë veprime të përshtatshme për mirëmbajtjen, inspektimin, ekzaminimin dhe testimin e burimeve dhe paisjeve të tjera që do të përdoren gjatë përgjigjes në raste emergjence.
188. Raporti i Sigurisë duhet të tregojë që janë ndërmarrë veprime të përshtatshme për trainimin e individëve brenda territorit në përgjigje të emergjencave. Ky trainim duhet të përfshijë ata anëtarë të stafit që kanë role specifike në rastin e aksidentit madhor si edhe dhënien e trajnimit e informacionit punonjësve të tjerë, kontraktorëve dhe vizitorëve në territor.
189. Raporti i Sigurisë duhet të përshkruajë procedurat për testimin dhe rishikimin e planit të brendshëm të emergjencës, dhe të rishikojë veprimet e emergjencës nën dritën e mësimave të nxjerra.

Informacion i kërkuar për Planin e Jashtëm të Emergjencës

190. Raporti i Sigurisë duhet të jetë pjesë e informacionit të dhënë njësisë së qeverisjes vendore për ta mundësuar atë të hartojë Planin e Jashtëm të Emergjencës.
191. Informacioni minimal që duhet përfshirë në raportin e sigurisë përmban:
- a. Detajet e territorit, përfshirë vendodhjen e tij, rrugët e afërta dhe hyrjen në territor;
 - b. Planin e territorit që tregon vendodhjen e impjanteve kryesore siç janë qendrat e kontrollit dhe qendrat mjekësore dhe vendodhjen e magazinave e impjantit kryesor të procesit;
 - c. Detaje për nivelet e personelit;
 - d. Detaje për zonat jashtë territorit që kanë gjasa të ndikohen nga aksidente madhore, dhe vlerësojnë nivelet e dëmtimeve rezultante;
 - e. Detajet e substancave të rrezikshme të mbajtura brenda territorit dhe informacion të ngjashëm për materialet e tjera të rrezikshme të mbajtura në territor;
 - f. Detajet e këshillave teknike që kompania mund të ofrojë për të asistuar në përgjigjen ndaj emergjencës;
 - g. Detajet përkatëse teknike për paisjet dhe burimet e tjera që normalisht mund të jenë të disponueshme në territor dhe që mund të jenë të

disponueshme për të asistuar shërbimet e jashtme të emergjencave gjatë përgjigjes së emergjencës;

- h. Funksionet e pozicioneve kryesore me detyra për përgjigjen ndaj emergjencave, vendodhjen e tyre dhe si mund të identifikohen; dhe
- i. Përmbledhjen me veprimet fillestare dhe procedurat e Planit të Brendshëm të Emergjencës që duhen ndjekur nga stafi brenda territorit sapo të jetë shpallur gjendja e emergjencës.

3 Udhëzime për planet e emergjencës

3.1 Hyrje

1. Qëllimi i kësaj pjese të Aneksit të këtij Vendimi është të ofrojë udhëzim të mëtejshëm mbi praktikën e mira për planifikimin e emergjencës. Informacioni do të jetë i dobishëm për të gjithë ata që kanë përgjegjësi për planifikimin e emergjencave, të brendshme dhe të jashtme, në ndërmarrjet me rreziqe nga aksidentet madhore; përfshirë operatorët, njësitë e qeverisjes vendore dhe shërbimet e emergjencës.
2. Ndërsa kërkesat e Ligjit për planifikimin e emergjencës aplikohen vetëm për ndërmarrjet e Nivelit më të Lartë, këto udhëzime mund të jenë të dobishme për ndërmarrjet e Nivelit më të Ulët në përcaktimin e veprimeve të tyre të emergjencës në Politikën e Parandalimit të Aksidenteve Madhore (PPAM).
3. Objektivat e planeve të emergjencës përcaktohen në Aneksin 4, Pjesa 1 e Ligjit. (në versionin anglisht ishte fjala “e Pjesës” por mendoj se duhet “e Ligjit”)
4. Duhet hartuar dy Plane Emergjence me shkrim për ndërmarrjet e Nivelit më të Lartë:
 - a. Plani i Brendshëm i Emergjencës, që përgatitet nga operatori, për të specifikuar përgjigjen ndaj emergjencës së atyre që punojnë në territor; dhe
 - b. Plani i Jashtëm i Emergjencës, që përgatitet nga njësia e qeverisjes vendore, siç përcaktohet në Ligj, për të specifikuar përgjigjen e koordinuar ndaj një emergjence brenda territorit, që ka efekte jashtë tij.
5. Dy Planet e Emergjencës duhet të detajojnë se si “përshtaten” së bashku. Plani i Brendshëm i emergjencës duhet të përfshijë veprimet që operatori ka vendosur për të asistuar në përgjigjen e emergjencave jashtë territorit; Plani i Jashtëm i Emergjencës duhet të përfshijë detaje për veprimet për dhënien e asistencës në përgjigjet ndaj emergjencave brenda territorit.
6. Kërkesat minimale për Planin e Brendshëm të Emergjencës përcaktohen në Aneksin 4, Pjesa 2 e Ligjit.
7. Kërkesat minimale për Planin e Jashtëm të Emergjencës përcaktohen në Aneksin 4, Pjesa 3 e Ligjit.
8. Punonjësit dhe personat e tjerë që punojnë brenda territorit, si edhe shërbimet e emergjencës duhet të konsultohen për Planin e Brendshëm të Emergjencës.
9. Shërbimet e emergjencës dhe publike duhen konsultuar para Planit të Jashtëm të Emergjencës.
10. Në të gjitha rastet kur mund të ndodhë një aksident madhor, që mund të çojë në dëmtime serioze të njerëzve apo mjedisit, planifikimi i duhur do të asistojë në minimizimin e pasojave të një aksident madhor. Planifikimi i mirë do të

asistojë në minimizimin e pasojave të atij aksidenti madhor. Planifikimi i mirë do të mundësojë gjithashtu optimizimin e burimeve.

11. Plani i emergjencës duhet t'i adresohet përgjigjes së kërkuar gjatë çdo faze të emergjencës, si për nevojat e menjëhershme ashtu edhe për rikuperimin afatgjatë. Orët e para pasi ndodh aksidenti mund të jenë fazë kritike e përgjigjes ndaj aksidentit, kur vendimet kryesore, që mund të ndikojnë suksesin e cilësdo prej masave zbutëse, duhet të merren nën presion të madh dhe brenda një periudhe kohore afatshkurtër. Për këtë arsye, të kuptuarit e detajuar të sekuencës së mundshme të ngjarjeve dhe masat e përshtatshme për t'iu përgjigjur situatës, do të ishte përfitim për të gjithë ata që llogjikisht pritet të luajnë një rol.
12. Përveç kësaj, në rastin e një investigimi pas një aksidenti madhor, plani i emergjencës mund të asistojë që të demonstron që palët në fjalë kanë bërë çdo gjë që llogjikisht pritet prej tyre gjatë përgatitjes për një aksident të tillë madhor.
13. Operatori dhe njësia e qeverisjes vendore kanë për detyrë që të sigurojnë që planet e duhura janë përgatitur dhe janë të përshtatshme për këtë qëllim. Operatori është përgjegjës për Planin e Brendshëm të Emergjencës dhe njësia e qeverisjes vendore është përgjegjëse për Planin e Jashtëm të Emergjencës. Në secilin rast, shkëmbimi i informacionit ndërmjet personave që kanë përgatitur planet dhe organizatave të tjera që kanë interes, është thelbësor për procesin e planifikimit dhe ka nevojë të zhvillohen konsultime të gjera me të gjitha palët.
14. Në përgatitjen e planeve të emergjencës, duhen përfshirë të gjitha autoritetet/organizatat me rol llogjikisht të parashikueshëm në përgjigjen e përgjithshme ndaj emergjencave, si të jetë e nevojshme. Shumë prej interesave të tyre mund të mbivendoset dhe me raste mund të jenë konfliktuale. Prandaj është thelbësore që të ketë bashkëpunim të mirë dhe të bëhen kompromise kur mund të jetë e nevojshme. Përfaqësuesit e lartë të organizatave kryesore duhet të takohen si grupi i lartë i koordinimit të emergjencave ose grup i ngjashëm, për të asistuar në zhvillimin e planit dhe testimin e regjimit si edhe për t'u konsultuar me organizata të tjera.
15. Pasi ndodh aksidenti madhor, rekomandohet që të krijohet grupi i koordinimit strategjik. Ky grup do të jetë përgjegjës për të siguruar që të gjitha organizatat e përfshira në përgjigjen ndaj aksidentit të jenë të përgatitura mjaftueshëm dhe që përfaqësuesit e kërkuar ndaj shumë organizatave të koordinohet siç duhet. Rekomandohet që një grup i tillë të përbëhet nga krye oficerët e shërbimeve të emergjencës, krye ekzekutivët e njësisë së qeverisjes vendore dhe nëse duhet përfaqësues me eksperiencë nga spitali lokal.
16. Gjatë përgatitjes së **Planeve të Brendshme të Emergjencës** operatori duhet të konsultohet me:
 - a. Punonjësit dhe kontraktorët afatgjatë;
 - b. Shërbimin e zjarrfikësit;
 - c. Policinë;

- d. Shërbimin e ambulancës;
 - e. Autoritetin shëndetësor lokal;
 - f. Shërbimin e Mbrojtjes Kombëtare;
 - g. Rojen bregdetare, nëse duhet;
 - h. Autoritetin Kompetent;
 - i. Njësinë e qeverisjes vendore.
17. Konsultimi i punonjësve dhe nënkontraktorëve afatgjatë në ndërmarrje rreth përbajtjes së Planit të Brendshëm të Emergjencës mund të realizohet nëpërmjet diskutimit direkt, diskutimit në grupe apo grupe pune ose zgjedhjes së duhur të përfaqësuesve të punonjësve.
18. Rolet e shërbimeve të emergjencës duhen diskutuar dhe rënë dakord përpara përfshirjes së tyre në veprimet e Planit të Brendshëm të Emergjencës. Kjo do të sigurojë që veprimet do të “përshtaten” me planet e përgjigjes të shërbimeve të emergjencës.
19. Në mënyrë të ngjashme duhet të konsultohet me njësinë e qeverisjes vendore për Planin e Brendshëm të Emergjencës. Kjo do të sigurojë një nivel të lartë “përshtatjeje” midis Planit të Brendshëm të Emergjencës dhe Planit të Jashtëm të Emergjencës.
20. Njësitë e qeverisjes vendore, **Planet e Jashtme të Emergjencës**, duhet të konsultohen me:
- a. Operatorin;
 - b. Autoritetin Kompetent;
 - c. Shërbimin zjarrfikës;
 - d. Policinë;
 - e. Shërbimin e ambulancës;
 - f. Autoritetin shëndetësor lokal;
 - g. Shërbimin e Mbrojtjes Kombëtare;
 - h. Rojen bregdetare, nëse duhet;
 - i. Publikun.
21. Autoritetet shëndetësore mbajnë përgjegjësi për shëndetin e publikut dhe duhet të vendosin masa për kontrollin e rreziqeve mjedisore, përfshirë shkarkimet kimike. Ata duhet të sigurojnë që janë marrë masat e duhura në ato spitale ku pritet të dërgohen persona të lënduar nga aksidentet madhore të marrë në konsideratë nga planet e emergjencës.
22. Gjithashtu, mund të jetë e nevojshme të konsultohet me institucione dhe organizata të tjera për përgatitjen e Planit të Jashtëm të Emergjencës. Këto mund të jenë institucione / organizata që mund të përfshihen në përgjigjen ndaj një aksidenti madhor dhe rolet e tyre do të duhet të përfshihen në Planin e Jashtëm të Emergjencës.

3.2 Përgatitja dhe përdorimi i planeve të emergjencës

23. Mekanizmi për hartimin e planeve të emergjencës duhet të strukturohet që të garantojë që kur të vihet në zbatim të japë përgjigjen e duhur ndaj aksidentit madhor.
24. Objektivat kryesore të planeve të emergjencës përcaktohen në Pjesën 1 të Aneksit 4 të Ligjit.
25. Megjithatë, komponentët kryesorë të procesit të planifikimit të emergjencës janë:
 - a. Identifikimi i burimeve, llojeve, shkallëve dhe pasojave të konsiderueshme të aksidenteve potenciale madhore;
 - b. Vendosja e objektivave të përgjigjes, si teknike ashtu edhe organizative;
 - c. Identifikimi i komponentëve (proçedurat, rolet dhe burimet – hardware dhe software) të kërkuar për të realizuar këtë përgjigje;
 - d. Identifikimi i organizatave dhe mbajtësve të posteve kryesore të përfshirë;
 - e. Identifikimi i ekspertizës, veprimeve dhe aftësive të organizatave dhe individëve që kanë lidhje me proçedurat dhe rolet e nevojshme si edhe mjaftueshmëria e burimeve të identifikuara për t’iu përgjigjur skenarëve të aksidenteve madhore të identifikuara;
 - f. Përcaktimi i mënyrës se si të gjitha përgjigjet do të kordinohen, përfshirë çdo “nën-plan”, siç janë veprimet me shërbimet e emergjencës;
 - g. Alokimi i përgjegjësive për përgjigjen dhe komponentët e lidhur me të;
 - h. Identifikimi i situatave kur proçedurat rutinë dhe burimet nuk janë të përshtatshme apo të mjaftueshme dhe çfarë duhet bërë në këto raste. Kjo duhet të përfshijë si të dallohet që është i nevojshëm ndryshimi nga rutina dhe si të zbatohet ky ndryshim; dhe
 - i. Identifikimi i mjeteve për të siguruar që planet do të vihen në zbatim ashtu siç synohet.
26. Planet e emergjencës duhen bazuar në nevojat specifike të çdo ndërmarrjeje të veçantë, emergjencat e parashikueshme që mund të lindin si edhe veprimet për të përballuar këto emergjenca. Planet e emergjencës duhet t’i adresohen gamës së plotë të aksidenteve të mundshme madhore të parashikuar për ndërmarrjen në fjalë, por shkalla e planifikimit duhet të jetë në raport me probabilitetin e ndodhjes së aksidentit.
27. Për Planet e Brendshme të Emergjencës, rreziqet nga aksidentet madhore të identifikuara në Raportin e Sigurisë duhet të krijojnë bazën për planifikimin e emergjencës.
28. Plani i Brendshëm i Emergjencës duhet të përfshijë detaje të veprimeve të kontrollit normal dhe të veçantë për t’u marrë me skenarët e aksidenteve madhore që janë parashikuar. Veprimet do të variojnë sipas rrethanave dhe duhet të marrin parasysh madhësinë dhe kompleksitetin e ndërmarrjes, natyrën e proçeseve dhe mbajtësve të materialeve, numrin e njerëzve të punësuar, disponueshmërinë e burimeve dhe vendodhjen e ndërmarrjes.

29. Plani i Brendshëm i Emergjencës duhet të jetë aspekt i sistemit të përgjithshëm të menaxhimit të sigurisë. Plani duhet të përfshijë veprime të përshtatshme dhe të koordinuara që duhet të sigurojnë që të gjithë njerëzit, burimet dhe informacionet e duhura janë të disponueshme dhe të vëna në veprim për t'u marrë në mënyrën e duhur me të gjithë gamën e emergjencave llogjikisht të parashikueshme.
30. Disa komponentë të planit të emergjencës kanë të bëjnë kryesisht me **përgjigjen**, për shembull:
- Kur dhe si të kontaktohen shërbimet e emergjencës;
 - Kush do të mbajë përgjegjësi dhe përse do të jenë përgjegjës;
 - Procedurat përkatëse për përgjigjen;
 - Procedurat speciale për t'u marrë me rrethana të veçanta;
 - Disponueshmëria e burimeve përfshirë kërkesën për paisje specialisti;
 - Ku dhe si të merret informacioni;
 - Si mund të identifikohen lehtë ata që u përgjigjen emergjencave dhe si ata mund të identifikojnë njëri tjetrin; dhe
 - Pika/t e takimit për ato që u përgjigjen emergjencave dhe si do të komunikojnë ata.
31. Komponentët e tjerë të planit të emergjencës kanë të bëjnë kryesisht me **bërjen e planit funksional**, p.sh.:
- Trainimi për planifikuesit e emergjencës;
 - Trainimi për njerëzit që luajnë rol në lidhje me planin;
 - Si plani (dhe komponentët e planit) do të testohet;
 - Si plani (dhe komponentët e planit) do të përditësohet; dhe
 - Si plani (dhe komponentët e planit) do të rishikohet dhe modifikohet për të marrë parasysh ndryshimet apo mësimet e nxjerra.
32. Planet e emergjencës duhet të dokumentohen me shkrim. Dokumentacioni duhet të jetë provë e marrëveshjeve dhe procedurave që mbulojnë të gjithë organizatat dhe njerëzit e duhur, të gjitha burime e nevojshme dhe të gamën e plotë të skenarëve të aksidenteve madhore llogjikisht të parashikuar.
33. Planet e emergjencës duhet të jenë sa më shumë koncize që të jetë e mundur, por jo në kurriz të detajeve thelbësore.
34. Një pjesë e mirë e planit të emergjencës është rreth shkëmbimit të informacionit dhe ideve midis njerëzve dhe organizatave. Konsiderata serioze i duhet dhënë mënyrës më efektive për ta kryer këtë, në rrethanat e një plani të veçantë emergjence.
35. Gjithashtu, i duhet dhënë konsideratë krijimit të lidhjeve midis atyre që janë deleguar për të mbajtur marrëdhëniet me median në emër të organizatave të ndryshme për përgjigje. Kjo duhet të sigurojë që është rënë dakord për dhe janë aprovuar nga të gjitha palët të gjitha deklaratat e dhëna në media dhe publik. Kjo do të përfshijë gjithashtu informacionin e dhënë nëpërmjet linjave të ndihmës së publikut.

36. Planet e emergjencës duhet të mbahen të përditësuara dhe të vihen në zbatim pa vonesë kurdo që kërkohen. Të gjithë ata që kanë role dhe përgjegjësi sipas planit duhet t'i kryejnë ato kur, ku dhe si kanë rënë dakord.
37. Parimet e nënvizuara në plan duhet të ndiqen gjatë trajnimit, testimin dhe në rastin e aksidentit aktual madhor.
38. Plani i emergjencës duhet të përmbajë të gjithë informacionin që llogjikisht presin të gjithë ata që përgjigjen ndaj emergjencës. Proçedurat që ai përmban për individët duhet të jenë të thjeshta dhe të drejtpërdrejta, nuk duhet të jenë kontradiktore dhe duhet të mundësojnë fleksibilitetin maksimal për përgjigje, në lidhje me madhësinë e ndërmarrjes.

3.3 Planet e Brendshme të Emergjencës

39. Plani i Brendshëm i Emergjencës mbulon përgjigjen e plotë të operatorit ndaj një aksidenti madhor që shkaktohet nga substanca të rrezikshme në ndërmarrje.
40. Plani i Brendshëm i Emergjencës duhet të fokusohet në ngjarjet e identifikuar me probabilitet më të lartë për të ndodhur. Niveli i planifikimit duhet të jetë në raport me probabilitetin e aksidentit që ndodh aktualisht.
41. Plani duhet të ketë fleksibilitetin të lejojë zgjerimin dhe rritjen e tij për të përballuar pasoja ekstremisht të pamundshme që mund të lindin nëpërmjet kombinimeve të rrethanave aksidentale dhe kushteve të motit.
42. Plani i Brendshëm i Emergjencës duhet të ofrojë detaje se si operatori përgatit njerëzit në ndërmarrje për një emergjencë dhe si kontrollon, përmban dhe zbut efektet e çdo emergjence. Gjithashtu, ai duhet të detajojë si do të kontaktohet asistenca nga organizatat e tjera jashtë territorit dhe si ata që punojnë në ndërmarrje do të asistojnë secilën prej këtyre organizatave të jashtme, përfshirë asistencën për secilën prej masave zbutëse jashtë territorit.
43. Në mënyrë që të arrihet përdorimi më i mirë i burimeve të disponueshme në rast emergjence dhe për të shmangur konfuzionin, Plani i Brendshëm i Emergjencës duhet të identifikojë personelin kryesor të caktuar (sipas emrit ose titullit të punës). Rekomandohet që emrat dhe numrat e telefonit të kontaktit të personelit të autorizuar të përfshihen në anekset e Planit, pasi kjo do të ndihmonte në përditësimin e ndryshimeve.
44. Ligji kërkon që Plani i Brendshëm i Emergjencës të përfshijë emrat apo pozicionet e njerëzve të autorizuar për të vënë në zbatim proçedurat e emergjencës, dhe të personit në ngarkim për të koordinuar përgjigjen lehtësuese brenda territorit. Këto dy funksione kryesore zakonisht i ngarkohen **“kontrolluesit të incidentit në territor”** dhe **“kontrolluesit kryesor në territor”**. Është e mundur që, për territore të vogla, këto dy role mund t'i ngarkohen të njëjtit person.

45. **Kontrolluesi i incidentit në territory** është përgjegjës për marrjen e kontrollit në skenën e aksidentit. Ky person duhet të ketë njohuri të hollësishtme për situatën e përgjithshme në afërsi të incidentit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur operacionet e ndërmarrjes janë ngushtësisht të ndërlidhura. Roli i kontrolluesit të incidentit të territorit mund të mbahet në mënyrë të përshtatshme nga menaxheri i ndërmarrjes, menaxheri i turnit apo mbikqyrësi i turnit në kohën kur ndodh incidenti. Është thelbësore që të sigurohet mbulimi i këtij roli 24 orë në ditë. Në ndërmarrjet që kanë një numër të vogël stafi apo që nuk kanë staf 24 orë në ditë, duhet të merren veprime menaxheriale të duhura për të kryer funksionet e nevojshme në rast emergjence.

46. Përgjegjësitë e kontrolluesit të incidentit në territor duhet të përfshijnë:

- a. Sapo kontrolluesi i incidentit në territor është njoftuar për një incident, ai/ajo duhet ta vlerësojë atë për të përcaktuar nëse ai mund të shndërrohet në aksident madhor. Nëse po, plani i brendshëm i emergjencës duhet të aktivizohet. Nëse është e nevojshme, plani i jashtëm i emergjencës duhet të aktivizohet gjithashtu.
- b. Deri në kohën që kontrolluesi kryesor i territorit është në detyrë, kontrolluesi i incidentit në territory duhet të hamendësojë përgjegjësitë e tij/saj. Në veçanti, përgjegjësi duhet të mbahet për:
 - i. Të siguroar që shërbimet e emergjencës janë njoftuar për alarmin,
 - ii. Të siguroar që alarmet e duhura të ndërmarrjes janë me zë,
 - iii. Të siguroar që publiku është informuar,
 - iv. Të drejtuar mbylljen dhe evakuimin e zonave të tjera të impjantit që kanë gjasa të ndikohen, dhe
 - v. Të siguroar që personeli kryesor është thirrur.
- c. Funkzioni kryesor i kontrolluesit të incidentit në territor është drejtimi i gjithë operacioneve në rastin e një aksidenti madhor në skenën e ngjarjes. Këto përgjegjësi kryesore përfshijnë:
 - i. Kontrollin e shpëtimit dhe përgjegjësitë e luftës kundër zjarrit derisa të vijnë shërbimet e emergjencës; kohë në të cilën kontrolli normalisht do të kalohet tek një oficer i lartë i zjarrfiksave,
 - ii. Punën me shërbimin e zjarrfiksave në kërkim të personave të lënduar, dhe
 - iii. Evakuimin e punëtorëve jo kryesorë për pikat e paracaktuara të mbledhjes.
- d. Kontrolluesi i incidentit në territor duhet gjithashtu të mbajë përgjegjësi për:
 - i. Vendosjen e një pike komunikimi me paisje të përshtatshme komunikimi për të kontaktur me **“qendrën/at e kontrollit të emergjencës”**,
 - ii. Dhënien e këshillave dhe informacionit, siç kërkohet, shërbimeve të emergjencës në skenën e ngjarjes,
 - iii. Informimin shkurt të kontrolluesit kryesor të territorit dhe mbajtjen e qendrës së kontrollit të emergjencës brenda territorit plotësisht të informuar për të gjitha zhvillimet e rëndësishme.

47. **Kontrolluesi kryesor i territorit** ka përgjegjësinë e përgjithshme të drejtojë operacionet nga qendra e kontrollit të emergjencës brenda territorit. Rekomandohet që ky pozicion të mbulohet nga një menaxher i lartë i ndërmarrjes, menaxher i ndërmarrjes apo drejtor që ka njohuri të përgjithshme për territorin.

48. Përgjegjësitë e kontrolluesit kryesor të territorit duhet të përfshijë:

- a. Ai/ajo duhet të shkojë në qendrën e kontrollit të emergjencës brenda territorit dhe të marrë përgjegjësi për kontrollin e përgjithshëm nga kontrolluesi i incidentit në territor.
- b. Nëse ekziston një emergjencë madhore, kontrolluesi kryesor i territorit duhet të konfirmojë që shërbimet e emergjencës janë thirrur dhe, nëse duhet, që është iniciuar plani i jashtëm i emergjencës.
- c. Në varësi të rrethanave dhe natyrës së incidentit, kontrolluesi kryesor i territorit duhet;
 - i. Të sigurojë që personeli kryesor është mobilizuar,
 - ii. Të sigurojë që kontrolli operacional direkt është i disponueshëm për ato pjesë të ndërmarrjes jashtë zonave të ndikuara drejtpërsëdrejti,
 - iii. Të rishikojë dhe vlerësojë zhvillimet, siç duhet, për të ndihmuar parashikimin e zhvillimeve më të mundshme të incidentit,
 - iv. Të drejtojë mbylljen e impjanteve dhe evakuimin e godinave, siç duhet, në konsultim me kontrolluesin e incidentit në territorin dhe personelin tjetër kryesor,
 - v. Të sigurojë që të gjithë personat e lënduar të marrin vëmendjen e duhur dhe, nëse duhet, të marrin masa për asistencë shtesë.
 - vi. Të sigurojë, në bashkëpunim me policinë që të mbahen të informuar të afërmit e personave të humbur apo të plagosur,
 - vii. Të vendosë kontaktet e duhura me shërbimet e parashikimit të motit për të siguruar që merret informacion paraprak në rastin e ndryshimeve kërcënuese në kushtet e motit,
 - viii. Të veprojnë si urë lidhëse me agjencitë e jashtme të duhura për të dhënë këshilla në efektet e mundshme në zonat jashtë ndërmarrjes,
 - ix. Të sigurojë që i gjithë personeli të raportojë vendodhjen,
 - x. Të kontrollojë lëvizjet e trafikut brenda ndërmarrjes,
 - xi. Të organizojë mbajtjen në vazhdimësi të të dhënave të emergjencës dhe përgjigjet e ndërmarra për të zbutur efektet e saj, për të dhënë prova të vendimeve të marra, veprimeve të kryera dhe për të siguruar që janë nxjerrë mësim nga përgjigja ndaj emergjencave,
 - xii. Të sigurojë nevojat për mirëqenien e personelit të ndërmarrjes (ushqim, pije, ndihmë, etj) dhe mjetet për të mbajtur të afërmit të informuar,
 - xiii. Të vendosë lidhje me mediat e lajmeve dhe të botojë informacion dhe deklaratat, siç duhet, dhe pas lidhjes me shërbimet e emergjencës,
 - xiv. Të sigurojë që është marrë plotësisht në konsideratë ruajtja e evidencave,

xv. Të kontrollojë rehabilitimin e zonave të ndikuara pas emergjencës.

49. **Qendra e Kontrollit të Emergjencës (QKE)** brenda territorit është impjanti kryesor që duhet marrë në konsideratë në Planin e Brendshëm të Emergjencës. QKE brenda territorit është vendi nga i cili drejtohen dhe koordinohen operacionet për të menaxhuar përgjigjen ndaj emergjencës. Normalisht, do të jetë vendi i zenë nga kontrolluesi kryesor i territorit, personeli tjetër kryesor siç duhet dhe nga oficerët e lartë të shërbimeve të emergjencës në gadishmëri për komandë dhe kontroll taktik dhe operacional.
50. QKE brenda territorit duhet të ketë lidhje të mira komunikimi me kontrolluesin e incidentit në territor dhe të gjitha instalimet e tjera në ndërmarrje. Gjithashtu, duhet të ketë lidhje të mira me pikat e përshtatshme jashtë territorit, që mund të jenë nëpërmjet shërbimeve të emergjencës brenda territorit. Këto lidhje duhet të përfshijnë:
- a. Selinë e shërbimeve të emergjencës;
 - b. Spitalet;
 - c. Selinë e kompanisë;
 - d. Autoritetet rregullatore;
 - e. Median (për të asistuar në dhënien e hershme të këshillave për shëndetin dhe sigurinë e publikut për të minimizuar vonesat).
51. Megjithatë, sapo të krijohet QKE jashtë territorit, pika e kontaktit me median do të jetë përfaqësuesi i lidhjes me median jashtë territorit.
52. QKE brenda territorit do të kërkojë fasilite për të regjistruar zhvillimin e incidentit për të asistuar në menaxhimin e tij dhe në vendimarrjen e metodës së përshtatshme të kontrollit. Duhet mbajtur evidenca për çdo investigim vijues.
53. Në përgjithësi, QKE brenda territorit duhet të përmbajë:
- a. Paisje për komunikimin e duhur të jashtëm jashtë territorit. Kjo do të përfshijë mekanizma për komunikimet brenda dhe jashtë, dedikuar personelit që përgjigjet për emergjencat, në mënyrë që të sigurojë që ata nuk tronditen / hutohen nga komunikimet me të afërmit apo fqinjët përkatës dhe mediat. Veprimet për komunikim duhet të përcaktohen për shërbimet e emergjencës, për t'i lidhur ato me impjantet e tyre të kontrollit qendror.
 - b. Paisje për komunikime të brendshme të përshtatshme. Kjo mund të realizohet nëpërmjet sistemit të telefonisë së brendshme, lidhjeve me radio apo mjeteve të tjera.
 - c. Hartat dhe planet e territorit të tregojnë qartë vendodhjen aktuale brenda territorit të:
 - i. Të gjithë zonave ku transportohen, magazinohen apo përpunohen materialet e rrezikshme,
 - ii. Të gjithë materialeve radioaktive,
 - iii. Paisjeve të sigurisë,

- iv. Furnizimeve me ujë kundër zjarrit, rrugën e burimeve kryesore me ujë kundër zjarrit dhe vendodhjen e të gjithë burimeve shtesë të ujit,
 - v. Kullimet dhe derdhjet tek rrjedhat ujore,
 - vi. Të gjithë materialeve të tjera kundër zjarrit,
 - vii. Pikat e hyrjes në ndërmarrje dhe sistemin rrugor brenda territorit. Duhet shenjuar për të treguar se cilat pika hyrjeje dhe rrugë mund të bëhen të papërdorshme me zhvillimin e incidentit,
 - viii. Impjantet kryesore të transportit për shërbimet e emergjencës, ngarkim shkarkimit dhe evakuimin e punonjësve,
 - ix. Pikat e grumbullimit dhe qendrat e trajtimit të të lënduarve,
 - x. Ndërmarrja lidhur me zonën përreth. Kjo duhet të identifikojë të gjitha popullsitë e ekspozuara (p.sh. spitalet, shkollat, etj.) ose karakteristikat e mjedisit.
- d. Planet e territorit që mund të jenë shenjuar për të treguar zhvillimin e incidentit dhe angazhimin e burimeve të përgjigjes ndaj emergjencës, zonat e evakuara dhe informacionin tjetër përkatës.
 - e. Fasilitetet për të siguruar që regjistrohen të gjitha mesazhet e dërguara dhe të marra.
 - f. Hyrje tek të gjithë të dhënat tek të gjithë ata që janë të pranishëm në territor në kohën e incidentit.
 - g. Numrat e duhur të kontaktit për të gjithë personelin që luan rol në përgjigje të incidentit.
54. I duhet dhënë konsideratë e kujdesshme vendodhjes së QKE brenda territorit. Kjo duhet të marrë në konsideratë vendodhjen/t e mundshme të burimeve të aksidenteve madhore në territor. QKE brenda territorit duhet të shpallet të mbetet operationale në të gjitha rastet me përjashtim të emergjencave më serioze.
55. Për ndërmarrjet e mëdha, apo kur shkarkimi toksik është skenar i një aksidentit llogjikisht të parashikueshëm, mund të jetë e përshtatshme të ngrihen dy qendra kontrolli për të siguruar që nën shumicën e rrethanave, njëra do të jetë e disponueshme nëse tjetra çaktivizohet.
56. Plani i Brendshëm i Emergjencës duhet të përfshijë strukturën e komandës së ndërmarrjes për të menaxhuar përgjigjen brenda territorit në përputhje me skemën e planifikuar, përfshirë menaxhimin e pastrimit dhe restaurimit përfundimtar. Do të ketë raste kur menaxherët e lartë mund të mos jenë të disponueshëm dhe masat e duhura duhen përfshirë në plan për këto rrethana. Rekomandohet që emrat dhe numrat e kontaktit për personelin e autorizuar të përfshihen në anekset e planit të emergjencës – për të lehtësuar përditësimin e ndryshimeve.
57. Plani duhet të përfshijë detajet e ngjarjeve të parashikueshme që mund të rezultojnë në aksidente madhore si edhe veprimet që duhen marrë në raste të tilla. Kjo duhet të përfshijë:
- a. Llojet e aksidenteve të parashikueshme për njerëzit dhe/ose mjedisin;
 - b. Strategjinë e synuar për të përballuar këto aksidente;

- c. Detajet e personelit që luan rol në përgjigjen ndaj emergjencave dhe përgjegjësitë e tyre;
 - d. Detajet e disponueshmërisë dhe funksioni i paisjeve speciale të emergjencës përfshirë materialet kundër zjarrit dhe artikujt e kontrollit dhe riparimit të dëmtimeve;
 - e. Detajet e disponueshmërisë dhe funksioni i burimeve të tjera.
58. Plani duhet të shpjegojë veprimet për kufizimin e risqeve ndaj njerëzve në territor. Kjo përfshin detaje të sistemeve, paisjeve dhe impjanteve për zbulimin e hershëm të një aksidenti madhor që po ndodh dhe përgjegjësitë për inicimin e përgjigjeve të përshtatshme nga personeli në territor (për t'u evakuar, strehuar, përdorur paisjet për mbrojtje personale, etj.).
59. Plani duhet të përfshijë detaje të veprimeve për dhënien e alarmit shërbimeve të emergjencës jashtë territorit dhe kur dhe në çfarë rrethanash duhet bërë një gjë e tillë. Plani duhet të përfshijë gjithashtu detaje të tipit të informacionit që kërkojnë shërbimet e emergjencës jashtë territorit, përpara dhe gjatë përgjigjes së tyre, në ç'formë, kujt dhe nga kush.
60. Plani duhet të përfshijë veprimet për trajnim dhe udhëzimin e personelit brenda territorit (punonjësit, kontraktuesit, vizitorët, etj) dhe veprimet për lidhjen me shërbimet e emergjencës jashtë territorit.
61. Masat për të ofruar asistencë me veprimet e zbutjes jashtë territorit duhet të përfshijë, për shembull, detaje të:
- a. Çdo paisje speciale, ekspertize apo impjanti që mund të përdorin shërbimet e emergjencës jashtë territorit; dhe
 - b. Rolit të personelit në ndërmarrje për të njoftuar shkurtimisht mediat.

Lista e kontrollit për Planet e Brendshme të Emergjencës

62. Pyetjet e mëposhtme mund të jenë të dobishme në vlerësimin e mjaftueshmërisë së Planit të Brendshëm të Emergjencës:
- a. A e mbulon plani gamën e incidenteve që duhen parashikuar në mënyrë realiste ?

Incidentet e konsideruara duhet të variojnë nga ngjarje të vogla në aksidente madhore. Operatorët e ndërmarrjeve të niveleve më të larta duhet të jenë në gjendje të justifikojnë, nga informacioni në Raportin e Sigurisë, qëllimin e planit të brendshëm të emergjencës, përfshirë:

- i. Ngjarjet e konsideruara dhe pse ato janë përfshirë apo përjashtuar,
- ii. Difektet tipike dhe dështimet që çojnë në këto ngjarje,
- iii. Shkallët kohore të përfshira,
- iv. Mundshmërinë e ngjarjeve për aq sa mund të vlerësohet llogjikisht, dhe
- v. Opsionet për minimizimin e ngjarjeve nëpërmjet masave zbutëse.

- b. A janë adresuar në mënyrën e duhur pasojat e incidenteve të ndryshme?

Çdo incident duhet vlerësuar përsa i përket sasisë së materialeve të rrezikshme që mund të shkarkohen si rezultat i një aksidenti, normës së shkarkimit, efekteve të shpërthimeve, efekteve të rrezatimit termal nga zjarret dhe efektet e materialeve të rrezikshme që mund të shkarkohen.

- c. A ka burime të mjaftueshme përsa i përket personelit dhe paisjeve në ndërmarrje, të disponueshme gjatë gjithë kohës, për të zbatuar planin e emergjencës për incidente të ndryshme në lidhje me shërbimet e emergjencës?

Për shembull, a ka ujë të mjaftueshëm për ftohjen dhe nëse ky ujë aplikohet nëpërmjet markuçëve, a ka mjaftueshëm njerëz të trajnuar për t'i përdorur?

- d. A janë vlerësuar siç duhet shkallët kohore?
- i. Gjatë hartimit të planit të emergjencës, duhet t'i jepet konsideratë kohës që do të kalojë nga fillimi i emergjencës tek mbërritja e shërbimeve të emergjencës dhe çdo kohe shtesë që do t'u duhet shërbimeve të emergjencës të vënë në përdorim burimet e tyre. Personeli që punon në ndërmarrje do të duhet të jetë në gjendje të përballojë emergjencën në zhvillim derisa të vijë shërbimet e jashtme të emergjencës.
 - ii. Disa shkarkime toksike mund të zhvillohen shumë shpejt. Nëse identifikohet një skenar i tillë shkarkimi në Raportin e Sigurisë atëherë masat pasuese riparuese duhet të jetë të shpejta në mënyrë të përshtatshme.
- e. A ekziston një sekuencë logjike e veprimeve për personelin kryesor që është identifikuar dhe i është dhënë një rol në planin e emergjencës?
- f. A ka pasur konsultime të përshtatshme me ata që punojnë në ndërmarrje?
- g. A janë ndërmarrë veprime për të mbuluar 24 orë në ditë? A janë marrë parasysh festat, sëmundjet, dorëzimet e turnit dhe mbylljet e impjantit?
- h. A janë bërë konsultime të mjaftueshme me zyrtarët e njësisë së qeverisjes vendore me përgjegjësi për të përgatitur Planin e Jashtëm të Emergjencës dhe me shërbimet e emergjencës për të siguruar që dy planet "përshtaten" së bashku siç duhet?
- i. A është ngritur grupi i koordinimit të emergjencës (apo diçka e ngjashme) ?
 - ii. A janë të qarta dhe a mjaftojnë veprimet në Planin e Brendshëm të Emergjencës për të iniciuar Planin e Jashtëm të Emergjencës?

3.4 Planet e Jashtme të Emergjecës

63. Plani i Jashtëm i Emergjencës duhet bazuar rreth rreziqeve nga aksidentet madhore (identifikuar nga operatori në Raportin e Sigurisë) që mund të ndikojnë njerëzit dhe mjedisin jashtë ndërmarrjes ose që mund të kërkojnë vemendjen e shërbimeve të emergjencës nga jashtë ndërmarrjes nëse lindin emergjenca.
64. Plani i Jashtëm i Emergjencës duhet të përqendrohet në ato ngjarje që janë identifikuar që kanë më shumë gjasa për të ndodhur.
65. Niveli i planifikimit duhet të jetë në raport me probabilitetin e aksidentit që ndodh. Plani duhet të ketë fleksibilitet për ta lejuar atë të zgjerohet dhe rritet për të përballuar pasoja ekstremisht të pamundshme që mund të lindin nëpërmjet kombinimeve të rrethanave aksidentale dhe kushteve të motit apo dukurive natyrore.
66. Njësia e qeverisjes vendore i kërkon operatorit të japë informacionin e nevojshëm rreth natyrës, shkallës dhe efekteve të mundshme të aksidenteve madhore llogjikisht të parashikueshme. Informacioni duhet të jetë i detajuar mjaftueshëm për të mundësuar njësinë e qeverisjes vendore të përgatisë Planin e Jashtëm të Emergjencës. Njësia e qeverisjes vendore mund të kërkojë çdo informacion shtesë që mund të duhet llogjikisht për të përgatitur planin.
67. Operatori duhet të rregjistrojë informacionin e dërguar tek njësia e qeverisjes vendore, burimin e informacionit dhe si duhet rishqyrtuar, ripunuar dhe përditësuar.
68. Shërbimet e emergjencës kanë detyrë të merren me aksidentet dhe emergjencat e të gjitha llojeve. Për këtë arsye Plani i Jashtëm i Emergjencës është kryesisht një mjet për të koordinuar planet ekzistuese të shërbimeve të emergjencës, sa më shumë që mundet, në përgatitjen e tyre për t'u marrë me rreziqet specifike dhe risqet e lidhura me aksidentet në ndërmarrjet me rreziqe nga aksidentet madhore. Kjo përfshin identifikimin e personelit kryesor nga një gamë organizatash dhe përcaktimin e detyrave të tyre në rast aksidenti.
69. Më pas do të jetë e mundshme të sigurohet që ata që janë identifikuar si të tillë, janë trajnuar siç duhet për të kryer këto role.
70. Njësia e qeverisjes vendore duhet të lidhet me operatorin e ndërmarrjes, shërbimet e emergjencës, Autoritetet Kompetente dhe publikun në përgatitjen e Planit të Jashtëm të Emergjencës.
71. Të gjitha kërkesat e marra nga autoritetet kompetente apo autoritetet e tjera për magazinim apo përdorim të substancave të rrezikshme duhet t'u bëhen me dije edhe njësisë së qeverisjes vendore, shërbimeve të emergjencës dhe autoriteteve apo agjencive të tjera përkatëse për të lejuar marrjen e hershme në konsideratë të implikimeve për planet e emergjencës të ndërmarrjeve të reja.

72. Veprimet e veçanta për secilën ndërmarrje të nivelit më të lartë duhet të jenë një dokument më vetë i cili mund të jetë aneks i planit të përgjithshëm që mbulon disa ndërmarrje.
73. Planet e emergjencës për ndërmarrjet e identifikuar që kanë potencial për efektin domino, duhet ta marrin parasysh këtë fakt dhe operatorët e përfshirë duhet të shkëmbejnë gjithë informacionin përkatës për të mundësuar planifikimin efektiv. Territore të tilla domino kërkojnë konsideratë të veçantë përse i përket planifikimit të emergjencës dhe testimit të përgjigjes ndaj emergjencave të jashtme.
74. Mund të jetë e nevojshme që njësitë e qeverisjes vendore të lidhen me njëra tjetrën ngushtësisht për planifikimin e emergjencave të jashtme kur një ndërmarrje është shumë pranë apo me një këmbë në kufirin e përbashkët midis njësisive të qeverisjes vendore.
75. Plani i Jashtëm i Emergjencës duhet të ofrojë detajet e njerëzve të autorizuar për të vënë në zbatim procedurat e emergjencës dhe njerëzit e autorizuar të kontrollojnë dhe koordinojnë veprimin jashtë territorit. Kjo duhet të përfshijë organizimin e menaxhimit për përgjigjen jashtë territorit në rastin e një emergjence dhe të përfshijë veprimet për menaxhimin e fazës së pastrimit dhe restaurimit të përgjigjes.
76. Plani duhet të përfshijë veprimet për marrjen e paralajmërimeve të hershme të incidenteve dhe dhënien e alarmit dhe procedurave të thirrjes. Kjo duhet të përfshijë detaje të:
- Si do të merret paralajmërimi nga shërbimet e emergjencës jashtë territorit për një aksident madhor aktual apo në zhvillim;
 - Si do të përshkallëzohet paralajmërimi sipas nevojës tek agjencitë e tjera të jashtme të përfshira apo që ka gjasa të përfshihen në përgjigjen ndaj një emergjence.
77. Plani duhet të përmbajë informacion se si do të mobilizohen burimet e identifikuar në veprimet e përgjigjes dhe si do të koordinohen veprimet e tyre. Kjo duhet të përfshijë:
- Cilat organizata luajnë rol në përgjigjen ndaj emergjencave të jashtme;
 - Rolet dhe përgjegjësitë e tyre;
 - Si çdo organizatë do të njoftohet për alarmin dhe si do ta vënë në zbatim përgjigjen e tyre;
 - Si do të komunikojnë organizatat dhe personeli që përgjigjet me personelin e ndërmarrjes. Kjo është e rëndësishme për të përfutur dhe transmetuar informacionin e nevojshëm për marrjen e vendimeve, në përputhje me rolet dhe përgjegjësitë e tyre për të cilat është rënë dakord;
 - Nëse është e nevojshme, vendodhja ku shërbimet e emergjencës, organizata të tjera dhe operatori i ndërmarrjes do të takohen jashtë territorit;
 - Si shërbimet e emergjencës dhe organizatat e tjera përgjegjëse do të fitojnë akses në ndërmarrje, në cilëndo paisje special apo në cilatdo burime të tjera që mund të kërkohen në përgjigje.

78. Gjithashtu plani duhet të përfshijë detaje të të gjitha veprimeve për dhënien e asistencës me masat zbutëse brenda territorit. Kjo shpesh mund të nënkuptojë që shërbimi i zjarrit do të vijë në ndërmarrje dhe do të marrë përgjegjësi të plotë për t'u marrë me përgjigjen ndaj emergjencës. Plani duhet të përfshijë detaje të:
- Tipeve të aksidenteve që mund t'u ndodhin njerëzve dhe / ose mjedisit;
 - Veprimeve për të vënë në dijeni shkurtimisht ata që arrijnë në ndërmarrje në emergjencën në zhvillim;
 - Strategjisë së propozuar për përgjigjen ndaj emergjencave për t'u marrë me tippet e aksidenteve të identifikuar në ndërmarrje;
 - Personelit që përgjigjet dhe përgjegjësive të tyre;
 - Detajet e disponueshmërisë dhe aplikueshmërisë së paisjeve speciale përfshirë materialet zjarrfikëse, artikujt për kontrollin dhe riparimin e dëmeve;
 - Detajet e disponueshmërisë dhe aplikueshmërisë së burimeve të tjera që mund të kenë lidhje.
79. Plani duhet të përfshijë veprimet për t'u marrë me aksidentet që kanë pasojë jashtë territorit. Kjo do të përfshijë, për shembull:
- Zbutjen e efekteve të aksidentit jashtë territorit;
 - Strehimin apo evakuimin e anëtarëve të publikut;
 - Kontrollin e trafikut dhe ruajtjen e rrugëve kryesore të emergjencës; dhe
 - Parandalimi i njerëzve që hyjnë në zonën e prekur.
80. Plani duhet të përfshijë detaje të veprimeve për t'i dhënë informacion publikut. Ky duhet të përfshijë informacion se si publiku në afërsi të ndërmarrjes do të:
- Njoftohet për alarmin në rast aksidenti;
 - Njoftohet çfarë duhet të bëjë;
 - Njoftohet që rreziku ka kaluar dhe ata mund të kthehen në shtëpitë e tyre.
81. Këto detaje tek publiku mund t'i referohen informacionit të parë që i është dhënë publikut në afërsi të ndërmarrjes.
82. Publiku mund të paralajmërohet me sirena, telefon, megafon apo mjete të tjera. Detajet duhet të përfshihen në plan. Informacioni i parë duhet të informojë publikun në afërsi të ndërmarrjes për mekanizmin e paralajmërimit, për shembull kuptimet e sirenave dhe alarmeve të ndryshme.
83. Plani mund të përfshijë gjithashtu detaje se si media do të përdoret për të transmetuar informacionin për shpërndarje të menjëhershme. Gjithashtu është e rëndësishme që plani të konsiderojë se si të merret me mediat e gjera në përgjigjen ndaj emergjencës. Qëllimi duhet të jetë që media dhe publiku të kuptojnë plotësisht emergjencën dhe të mos e shqetësojnë publikun padrejtësisht.
84. Atje ku është e nevojshme, plani duhet të detajojë veprimet për dhënien e informacionit shteteve të tjera në rastin e një emergjence me pasojë të

mundshme ndërkufitare. Kjo është diçka që duhet diskutuar me Autoritetet Kompetente.

85. Përgjigja ndaj një aksidenti madhor në territory do të menaxhohet përmes niveleve taktike dhe operacionale të komandës dhe kontrollit. Kjo duhet të jetë nëpërmjet një grupi brenda territorit të përbërë nga ata përfaqësues të organizatave që përgjigjen me pushtet ekzekutiv për të drejtuar burimet e organizatës së tyre dhe që janë në gjendje, nëse kërkohet, të thërrasin burimet shtesë.
86. Në nivel strategjik, **grupi i koordinimit strategjik** apo grupi i ngjashëm me të, do të takohet normalisht në **qendrën e kontrollit të emergjencës jashtë territorit** në një distancë të sigurt nga vendodhja e aksidentit. Grupi mund të përbëhet nga oficerë të lartë që përfaqësojnë policinë, shërbimin e zjarrfikësive, shërbimin e ambulancës, njësinë e qeverisjes vendore, Autoritetet Kompetente dhe të tjerë sipas nevojave. Grupi mund të kryesohet nga oficeri i lartë i policisë në fazat fillestare, por kjo mund të kalojë tek oficeri i lartë i njësisë së qeverisjes vendore në fazat e mëvonshme. Megjithatë, grupi duhet të përpiqet të punojë së bashku si ekip.
87. Pasi krijohet në QKE jashtë territorit, grupi i koordinimit strategjik duhet të marrë menaxhimin e aspekteve të përgjigjes së emergjencës jashtë territorit nga QKE brenda territorit. Kjo do të mundësojë ata që janë brenda territorit të përqendrohen në çështjet taktike dhe operacionale për ta vënë incidentin në kontroll.

3.5 Aspektet e shëndetit publik nga aksidentet madhore

88. Nga pikëpamja e shëndetit public, aksidentet madhore që shkaktohen nga substanca të rrezikshme paraqesin karakteristika speciale që duhen marrë në konsideratë nga operatorët dhe njësitë e qeverisjes vendore gjatë hartimit, testimit dhe rishikimit të planeve të tyre përkatëse të emergjencës.
89. Këto karakteristika speciale përfshijnë:
- a. Për shumë kimikate mund të ketë pak ose aspak informacion të disponueshëm në lidhje me efektet e tyre për shëndetin e njeriut;
 - b. Kimikatet e rrezikshme të përfshira në një aksident mund të tjetërsohen kimikisht apo fizikisht nga zjarri, ajri, uji, reaksioni kimik me njëra tjetrën apo nga metabolizmi i njeriut;
 - c. Efektet në shëndet nga kimikatet e rrezikshme mund të variojnë në varësi të rrugëve dhe kohëzgjatjes së ekspozimit dhe ekspozimit individual;
 - d. Punëtorët, punëtorët e përgjigjes ndaj emergjencave dhe zyrtarët shëndetësor do të jenë edhe vetë në rrezik nëpërmjet kontaktit me personat e lënduar e kimikisht të kontaminuar. Megjithatë, përdorimi i duhur i paisjeve mbrojtëse do ta minimizojë një kontaminim të tillë;
 - e. Kapaciteti i spitaleve për të përballuar të lënduarit e kontaminuar do të jetë i kufizuar;
 - f. Spitalet mund të shtrihen në rrugën e shtëllunge kimike;

- g. Popullsitë e shpërndara mund të preken nëpërmjet kontaminimit të ujit dhe/ose zinxhirit ushqimor;
 - h. Aksidentet shpesh mund të shkaktojnë panic tek njerëzit gjë që mund të sjellë rritjen e numrit të njerëzve që shkojnë në spital.
90. Në hartimin e komponentëve të planeve përkatëse lidhur me shëndetin publik dhe në arritjen e menaxhimit të integruar të emergjencave, operatorët dhe njësitë e qeverisjes vendore duhet të konsultohen me autoritetet shëndetësore lokale dhe shërbimin e ambulancës dhe bashkarisht të bien dakord për rolet dhe përgjegjësitë respektive.
91. Disa substanca kimike mund të shkaktojnë efekte të dëmshme të vonuara në vijimësi të ekspozimit fillestar, madje edhe pas dekontaminimit të shpejtë. Të gjitha shërbimet për përgjigje ndaj emergjencave mjekësore duhen përfshirë në planet e tyre të emergjencës, udhëzimet dhe procedurat në mënyrë që i gjithë personeli i përgjigjes ndaj emergjencave fillestare dhe ai i kujdesit të mëtejshëm të jetë i ndërgjegjshëm për mundësitë e shenjave dhe simptomave të vonuara.
92. Aspektet e shëndetit publik nga aksidentet madhore do të vazhdojnë pa ndryshim pasi incidenti në ndërmarrje të jetë vënë nën kontroll.
93. Kërkohet që operatorët të kryejnë vlerësime periodike për sigurinë mbi natyrën dhe shkallën e skenarëve të aksidenteve të mundshme. Ky informacion duhet të ndahet me autoritetet shëndetësore në mënyrë që ato të jenë në pozicion më të mirë për të siguruar që burimet e ndryshme mjekësore dhe të shëndetit publik për emergjenca që mund të kërkojnë do të jenë të disponueshme menjëherë, për t'u marrë me tippet e ndryshme të aksidenteve dhe gamën e të lënduarve të mundshëm.
94. Operatorët dhe njësitë e qeverisjes vendore duhet të punojnë ngushtësisht me autoritetet shëndetësore dhe shërbimet e tjera të emergjencës kur të marrin në konsideratë ku dhe kur do të realizohet dekontaminimi i të lënduarve dhe personelit që i përgjigjet emergjencave. Ata do të kërkojnë gjithashtu marrjen në konsideratë të paisjeve mbrojtëse të nevojshme për personelin.
95. Njësitë e qeverisjes vendore duhet të diskutojnë me autoritetet shëndetësore dhe autoritetet e tjera përkatëse rreth përfshirjes së veprimeve në Planin e Jashtëm të Emergjencës për të menaxhuar nevojat shëndetësore të individëve që janë evakuar.
96. Operatorët dhe njësitë e qeverisjes vendore duhet të jenë të ndërgjegjshëm për burimet e këshillave dhe ekspertizës së specialistëve dhe informacionit të vlefshëm për personelin shëndetësor të përfshirë në menaxhimin e aksidenteve madhore. Në të njëjtën mënyrë, autoritetet shëndetësore duhet të jenë të ndërgjegjshme për burimet e informacionit dhe ekspertizën mbi efektet e kimikateve të rrezikshme. Vetë industria kimike mund të mbajë shumë prej këtij informacioni.

97. Veprimet kryesore të përgjigjes të caktuara për autoritetet shëndetësore përfshijnë:
- a. Vlerësimin e riskut për shëndetin e publikut nën dritën e të dhënave toksikologjike të disponueshme për kimikatet e shkarkuara, rezultatet e kampioneve biologjike dhe mjedisore, të gjitha gjetjet epidemiologjike dhe marrja e këshillës dhe mbështetjes nga specialisti i duhur;
 - b. Këshillimi mbi masat e nevojshme për të kufizuar apo parandaluar ekspozimin e mëtejshëm ndaj publikut për kimikatet e shkarkuara në një aksident.

3.6 Aspektet mjedisore të aksidenteve madhore

98. Ekziston nevoja të merret parasysh mjedisi sin ë Planet e Brendshme edhe ato të Jashtme të Emergjencës.
99. Mjedisi, për këto qëllime, përbëhet nga karakteristika të ndërtuara, ajri, uji, toka, flora dhe fauna. Një aksident konsiderohet madhor nëse shkakton dëme të përhershme apo afat-gjata në një komponent të veçantë unik, të rrallë apo ndryshe me vlerë të mjedisit të krijuar apo atij natyror, apo nëse ekzistojnë humbje mjedisore, kontaminime apo dëme të përhapura gjerësisht.
100. Efekti i një aksidenti në mjedisin natyror mund të jetë i drejtpërdrejtë apo jo i drejtpërdrejtë, i menjëhershëm apo i vonuar, i përkohshëm apo i vazhdueshëm.
101. Për këtë arsye, efektet jo të drejtpërdrejta të një aksidenti duhet të merren në konsideratë gjithashtu. Kjo mund të përfshijë marrjen në konsideratë të punimeve tek uji dhe ujërat e zeza, ushqimi dhe bujqësia.
102. Planet përkatëse të emergjencës të zhvilluara nga operatorët dhe njësitë e qeverisjes lokale duhet të marrin në konsideratë:
- a. Skenarët e aksidenteve të mundshëm;
 - b. Efektet mjedisore të parashikuara të aksidenteve;
 - c. Zbatimin e masave specifike për të mbrojtur mjedisin;
 - d. Lidhjen me autoritetet e tjera mjedisore dhe publikun;
 - e. Pastrimin dhe restaurimin mjedisor.
103. Raporti i Sigurisë duhet të përmbajë shumicën e informacionit të kërkuar për qëllime planifikimi dhe do të jetë vlerësuar nga Autoritetet Kompetente. Megjithatë, njësia e qeverisjes vendore duhet të konsultohet me Autoritetet Kompetente dhe autoritetet e tjera mjedisore përpara se të finalizohet Plani i Jashtëm i Emergjencës.
104. Efektet e një aksidenti në mjedis varen nga një sërë faktorësh specifik për aksidentin. Operatorët duhet të kenë kryer një vlerësim të detajuar të riskut mjedisor si pjesë e Raportit të tyre të Sigurisë. Ky informacion mund të përdoret për të ndihmuar hartimin e Planeve të Brendshme dhe të Jashtme të Emergjencës. Qëllimi i vlerësimit të riskut është të tregojë se cilat rreziqe dhe dukuri kontribuojnë në risqet ndaj mjedisit nga një aksident në ndërmarrje. Kjo do të lejonte vendosjen e përparësive në përpjekjet për të menaxhuar këto

risqe. Sasia e detajeve për çdo veprim duhet të jetë në raport me riskun e paraqitur nga ndërmarrja.

105. Vlerësimet e riskut duhet të marrin në konsideratë:
 - a. Substancat dhe proceset e pranishme në ndërmarrje;
 - b. Rrugët e kontaminimit nga ndërmarrja në mjedis;
 - c. Vendodhjen e ndërmarrjeve në lidhje me karakteristikat e mjedisit.
106. Natyra e cilësdo ndotje përcaktohet nga aktivitetet në ndërmarrje dhe substancat e rrezikshme të pranishme apo që shkarkohen në rastin e një aksidenti. Planet e emergjencës duhet të fokusohen në ato dukuri dhe substanca që kanë më shumë gjasa të shkaktojnë dëm në mjedis.
107. Jo të gjitha shkarkimet në mjedis shkaktajnë dëme. Prandaj është e rëndësishme të dihet toksiciteti dhe sjellja e çdo kimikati që mund të shkarkohet në mjedis. Përveç kësaj, disa substanca të padëmshme në dukje mund të kenë efekt dëmtues në mjedis nëse shkarkohen. Shkalla e zgjatjes/vazhdimësisë së cilitdo kimikati ka të ngjarë të ketë rëndësi.
108. Për të vlerësuar zonat që mund të preken në rastin e një aksidentit, duhen ekzaminuar të gjitha rrugët e mundshme nëpërmjet të cilave ndotësit mund të arrijnë në mjedis. Dy rrugët kryesore për kontaminimin e mjedisit janë nëpërmjet ajrit dhe nëpërmjet ujit; por, gjithashtu, ndotësit mund të penetrojnë edhe nëpërmjet tokës.
109. Efektet e ndotjes me burim ajror mund të mbulojnë një zonë të gjerë dhe janë më të vështira për t'u parashikuar dhe kontrolluar sesa ndotësit që shkarkohen në ujë. Zona e prekur do të varet nga kushtet e motit. Informacioni mbi shpejtësinë dhe drejtimin e erës (mendoj se fjala wide duhet te jete shkruar gabim në vend të wind) marrë nga shërbimet meteorologjike do të ndihmojë për të përcaktuar zonën që ka më shumë gjasa për t'u prekur.
110. Derdhjet sipërfaqësore tek kanalet e mbledhjes së ujërave, kanalet kulluese dhe rrjedhat ujore mund të shkaktojnë efekte të rrymës, dhe potencialisht ta mbartin ndotjen shumë larg nga vendi i aksidentit.
111. Në përgatitjen e planit të emergjencës për mbrojtjen e mjedisit, do të jetë e rëndësishme që të karakterizohen tiparet e ambientit rreth ndërmarrjes. Përcaktimi i zonave veçanërisht të rëndësishme ose të ndjeshme do të identifikojë ato fusha për të cilat masa të veçanta mbrojtëse mund të duhet të zbatohen.
112. Megjithatë, nuk kërkohet një auditim i hollësishëm ekologjik. Një studim paraprak mund të përdoret për të karakterizuar tiparet e gjera të përdorimit të tokës në këtë zonë - për shembull ato të banimit, bujqësore, peshkimit, pyjore, etj. Megjithatë, mund të jenë të nevojshme disa forma të studimit të mjedisit dhe autoritetet e mjedisit mund të këshillojnë për këtë.
113. Duhet të identifikohen të gjitha zonat ekologjike të ndjeshme brenda rrezes së ndërmarrjes. Në rastin e lumenjve dhe trupave të tjera ujore, zonat e

ndjeshme të vëna në rrezik nga një aksident, mund të jenë në një distancë nga ndërmarrrja.

114. Planet e emergjencës duhet të identifikojnë veprime dhe masa specifike për të parandaluar dhe zbutur ndikimin e një aksidenti në mjedis. Duke pasur parasysh nevojën për veprime dhe masa të veçanta që më parë, mund të merren vendime të njoftuara që do të ndihmojnë në maksimizimin e nivelit të mbrojtjes së mjedisit nga planet.
115. Për të gjitha vendimet dhe veprimet duhet rënë dakord dhe duhen provuar më parë me organizatat përkatëse. Është e qartë se është e rëndësishme që të njihet se opsionet e konsideruara nuk duhet të bien ndesh me masat për të mbrojtur shëndetin e njeriut.
116. Është e rëndësishme që për aspektet e planeve të emergjencës për mbrojtjen e mjedisit të bihet dakord me të gjitha palët e përfshira në përgjigje të aksidentit, apo me përgjegjësi për çdo zonë, habitat, specie ose ndërtesë që mund të preket.
117. Shërbimi i zjarrfikësave do të duhet të dijë se ku janë furnizimet me ujë të ndjeshëm: për të ndihmuar shmangien e heqjes së tepërt të tyre për të shuar zjarrin dhe për të ndihmuar shmangien e ndotjes së ujit me anë të ujit të derdhur të ndotur.
118. Mund të jetë e nevojshme të komunikohet me autoritetet mjedisore për krijimin e cilësisë së ujit në trupat ujore vendore, pikat e nxjerrjes së ujit, praninë e shtresave ujëmbajtëse dhe ekspozimin e këtyre karakteristikave ndaj ndotjes. Planet duhet të përfshijnë masa për të parandaluar përhapjen e ndotjes – siç mund të jenë gjësimet, njomja e ndotësve dhe devijimi i rrjedhave ujore.
119. Mund të jetë e nevojshme për të komunikuar me autoritetet / kompanitë e ujit për të shmangur dëmtimin e ujit dhe instalimet e ujërave të zeza.
120. Planet e brendshme dhe të jashtme të emergjencës duhet të sigurojnë pastrimin dhe restaurimin e mjedisit pas një aksidenti. Masat korrigjuese duhet të jenë në raport me sasinë e dëmit të shkaktuar nga aksidenti, si dhe nivelin e mundshëm të dëmtimit të vazhdueshëm të njerëzve dhe mjedisit.
121. Planet e emergjencës mund të marrin parasysh dhe identifikojnë procedurat dhe masat, kur është e përshtatshme, për:
 - a. Largimin e tokës së ndotur dhe debrisit;
 - b. Kufizimin e ushqimeve (përfshirë ato të rritura në shtëpi);
 - c. Kufizimin e hyrjes në këto zona;
 - d. Rifurnizimin e trupave ujore, pyjeve, etj.;
 - e. Masat korrektuese për furnizimet me ujëra sipërfaqësore dhe tokësore.
122. Zonat e ndotura, madje edhe ato brenda territorit, mund të përbëjnë një kërcënim të vazhdueshëm për mjedisin pas një aksidenti. Pastrimi mund të kërkojë largimin ose pastrimin e tokës, hiri mund të ketë nevojë të mblidhet për të parandaluar përhapjen e tij me anë të erës dhe enët me kimikate mund të kenë nevojë të jenë të etiketuara dhe të asgjësohen në mënyrë të sigurtë nga

kontraktorë të liçencuar për asgjësimin. Ujërat e ndotur të mbajtur në struktura izoluese mund të kenë nevojë të largohen dhe të përpunohen për t'u bërë të sigurtë dhe jo-toksikë.

123. Shkalla e veprimeve korrektuese të mbuluara nga Planet e Jashtme të Emergjencës duhet të marrin parasysh rreziqet e veçanta mjedisore që lidhen me operacionet e kryera në ndërmarrje dhe kushtet e veçanta mjedisore jashtë territorit.
124. Një çlirim kimik gjatë një aksidenti mund të çojë në ndotjen e zinxhirit ushqimor, ose nëpërmjet depozitave të drejtpërdrejta mbi të korrat apo tokat kullotë, ose nëpërmjet thithjes së ujit të ndotur nga bimët. Mund të jetë e nevojshme të komunikohet me autoritetet shëndetësore dhe bujqësore për të përcaktuar masat e nevojshme për parandalimin e ushqimeve të ndotura që hyjnë në zinxhirin e ushqimit.

3.7 Trainimi dhe testimi

125. Raporti i sigurisë kërkon prova se sistemi i menaxhimit të operatorit përmban veprime të përshtatshme për trajnimin e individëve të ndërmarrjes në përgjigje ndaj emergjencave. Lloji i trajnimit të duhur varet nga roli i individit në rastin e një emergjence. Kjo duhet të mbulojë anëtarët e stafit me një rol të veçantë në përgjigjen ndaj emergjencave, si edhe anëtarë të tjerë të stafit, kontraktorëve dhe vizitorëve të ndërmarrjes.
126. Trajnimi duhet të mbahet i përditësuar si të jetë e përshtatshme, me kurse rifreskuese të përshtatshme. Qëllimet dhe objektivat e trajnimit duhet të bëhen të qarta në fillim të trajnimit gjithmonë dhe efektiviteti i trajnimit duhet të rishikohet dhe të vlerësohet.
127. Planet e emergjencës duhet të testohen të paktën një herë në çdo tre vjet.
128. Testimi kryhet për të siguruar që planet janë të sakta, të plota dhe të praktikueshme. Duhet të jetë në gjendje të tregohet se njerëzit në ndjekje të planit të emergjencës mund të përballen me një gamë aksidentesh që mund të ndodhin. Testimi duhet të japë një tregues të kushteve që mund të ekzistojnë brenda dhe jashtë ndërmarrjes në rastin e një emergjence.
129. Testimi duhet të tregojë gjithashtu se plani do të funksionojë siç është propozuar: kontrolli dhe zbutja e efekteve të një aksident, komunikimi i informacionit të nevojshëm dhe inicimi i masave që do të çojnë në restaurimin e nevojshëm të mjedisit.
130. Testimi duhet të bazohet në një skenar aksidenti të identifikuar në raportin e sigurisë si i parashikueshëm llogjikisht. Testimi duhet të adresojë përgjigjen gjatë fazës fillestare të emergjencës, e cila përkon zakonisht me orët e para pasi ka ndodhur aksidenti. Kjo është faza e përgjigjes ndaj aksidentit kur vendimet kryesore që do të ndikojnë në suksesin e çdo mase zbutëse, duhet të merren nën presion të konsiderueshëm dhe brenda një periudhe të shkurtër

kohore. Prandaj ky është vendi ku një kuptim i detajuar i rendit të mundshëm të ngjarjeve të kundër-masave të përshtatshme është me përfitim të madh.

131. Është e rëndësishme që çështjet e thjeshta të mos anashkalohen duke u përqëndruar në aspektet më komplekse të përgjigjes ndaj emergjencave. Regjimi i përgjithshëm i testimi duhet të marrë parasysh, gjatë një periudhe kohore, gamën e plotë të rreziqeve të afta për të shkaktuar një aksident madhor dhe jo vetëm rreziqet më të rëndësishme.
132. Testimi i Planeve të Jashtme dhe të Brendshme të Emergjencës (ose testimi i pjesëve të planeve), në të njëjtën kohë mund të japë përfitime të konsiderueshme. Këto përfitime përfshijnë garantimin që të dy planet e emergjencës funksionojnë në mënyrë efektive së bashku dhe ofrojnë kursime financiare potenciale financiare duke shmangur testimet e dyfishta.
133. Rregjimi i përgjithshëm i testimi të Planeve të Jashtme dhe të Brendshme të Emergjencës pritet të ekzaminojë aspektet e mëposhtme të përgjigjes ndaj emergjencave:
 - a. Aktivizimin e planit të emergjencës dhe njoftimin e pjesëmarrësve;
 - b. Njoftimin e shërbimeve të emergjencës;
 - c. Vënien në punë të alarme zanore;
 - d. Mobilizimin e personelit të ndërmarrjes të identifikuar në planet e emergjencës që luan rol në rastin e një emergjence;
 - e. Krijimin e një QKE brenda territorit;
 - f. Krijimin e një QKE jashtë territorit;
 - g. Dhënien e informacionit QKE-ve;
 - h. Komunikimet brenda QKE-ve;
 - i. Punën në grup;
 - j. Marrjen e vendimeve;
 - k. Komunikimin dhe informimin e publikut;
 - l. Pajisjet dhe impjantet.
134. Ushtrimet për të testuar planet e emergjencës mund të marrin një sërë formash të ndryshme, të cilat do të përmbushin funksione të ndryshme në kuadër të kërkesave të përgjithshme. Këto përfshijnë:
 - a. Stërvitjet;
 - b. Seminaret;
 - c. Ushtrimet (Ëalk-through) me demonstrim të detajeve dhe procedurave;
 - d. Ushtrimet (Table-top) me diskutime në grup të drejtuara nga një aksident i simuluar;
 - e. Ushtrimet pas kontrollit;
 - f. Ushtrimet direkte.
135. Do të jetë e rëndësishme të hartohet një program për testimin e planeve të emergjencës të përgatitura bashkërisht dhe të rëna dakord nga të gjitha agjencitë që pritet të marrin pjesë. Kjo krijon një nivel të lartë besimi tek plani

pa e mbingarkuar operatorin dhe organizatat e tjera për t'iu përgjigjur emergjencave.

136. Do të jetë e rëndësishme të vlerësohen mësimet e nxjerra nga testimi i planeve të emergjencës dhe të përcaktohet nëse kërkohen ndryshime për planin e emergjencës dhe të promovohen praktikatat e mira. Ky proces vlerësimi duhet të përfshijë shpërndarjen e informacioneve dhe mësimet e nxjerra, sipas rastit, tek organizatat përkatëse të përfshira për t'iu përgjigjur emergjencave.
137. Konsiderohet praktikë e mirë që publiku në afërsi të ndërmarrjes të paralajmërohet para çdo testimi të planeve të emergjencës. Kjo do të shmangë çdo shqetësim të kotë nga ana e publikut.

3.8 Inicimi i Planeve të Emergjencës

138. Ligji kërkon që personi i cili ka përgatitur një plan emergjence të marrë hapat e nevojshëm për të siguruar që plani të vihet në jetë pa vonesë kur:
 - a. Ndodh një aksident madhor; apo
 - b. Ndodh një ngjarje e pakontrolluar që nga natyra e saj mund të pritet llogjikisht që të çojë në një aksident madhor.
139. Prandaj planet e emergjencës të përgatitura nga operatori dhe njësia e qeverisjes vendore duhet të vendosin veprime të përshtatshme për të iniciuar planet e emergjencës.
140. Plani i emergjencës duhet të identifikojë se kush e ka përgjegjësinë për iniciimin e planit të emergjencës dhe kur duhet të bëhet një gjë e tillë. Plani duhet të përfshijë gjithashtu edhe se kur duhen njoftuar shërbimet e emergjencës për alarmin për të siguruar që nuk do të ketë vonesa të panevojshme me pasoja të rënda.
141. Operatori dhe njësia e qeverisjes vendore duhet të bien dakord se kush ka autoritetin për të aktivizuar alarmin jashtë territorit apo mjetet e tjera për paralajmërimin e publikut që ka ndodhur një aksident dhe se kur kjo duhet të bëhet kjo gjë. Për këtë duhet të bihet dakord gjatë hartimit të planit të emergjencës për të shmangur çfarëdo vonese të panevojshme gjatë përgjigjes së një emergjence. Nën shumicën e rrethanave mund të jetë e përshtatshme të identifikohet një punonjës në ndërmarrje (me emër apo pozicion) në planin e emergjencës që të ketë përgjegjësinë për aktivizimin e alarmit jashtë territorit. Megjithatë, në disa raste (siç është rasti i një ndërmarrjeje që nuk punon 24 orë në ditë), mund të jetë më e përshtatshme në qoftë se ky funksion kryhet nga anëtari i emergjencës së parë të shërbimit të zjarrfikësve të jashtëm që arrin në ndërmarrje.

3.9 Shqyrtimi dhe rishikimi i Planeve të Emergjencës

142. Të paktën një herë në çdo tre vjet planet e emergjencës duhet të shqyrtohen dhe, kur është e nevojshme, të rishikohen.

143. Rishikimi i planit të emergjencës duhet të konsiderohet si një proces thelbësor që ekzaminon përshtatshmërinë dhe efektivitetin e komponentëve të planit të emergjencës dhe mënyrën se si ata funksionojnë së bashku. Procesi i shqyrtimit duhet të marrë në konsideratë:
- Të gjitha ndryshimet materiale në aktivitetin e ndërmarrjes;
 - Çdo ndryshim në shërbimet e emergjencës që ka lidhje me funksionimin e planit;
 - Përparimet në njohuritë teknike, të tilla si mjetet e reja dhe më efektive të zbutjes;
 - Ndryshimet në burimet e stafit, duke përfshirë edhe kontraktuesit;
 - Njohuritë e fituara si rezultat i aksidenteve madhore ose në vend ose diku tjetër; dhe
 - Mësimet e nxjerra gjatë testimit të planeve të emergjencës.
144. Që shqyrtimi dhe rishikimi të kryhen në mënyrë efektive, duhet të ketë komunikim të hapur ndërmjet operatorit, njësisë së qeverisjes vendore dhe shërbimeve të emergjencës. Të gjitha ndryshimet e duhura të cilat mund të ndikojnë në përgjigjen ndaj emergjencave duhet t'u komunikohen palëve të tjera.
145. Gjithashtu duhet bërë një rishikim i Planit të Brendshëm të Emergjencës dhe Planit të Jashtëm të Emergjencës pas çdo modifikimi të rëndësishëm në ndërmarrje apo ndryshimeve të tjera të rëndësishme. Në këto rrethana, plani duhet të shqyrtohet pa prituri për shqyrtimin tre vjeçar.
146. Shqyrtimi dhe rishikimi do të konsiderohen si një kërkesë e veçantë nga përditësimi i planit të emergjencës, që është një proces i vazhdueshëm. Përditësimi kryhet për të pasqyruar të gjitha ndryshimet në detajet praktike e masat e përgjigjes ndaj emergjencave, të tilla si ndryshimet në përgjigjen e veprimeve komunikuese të organizatave ose në pajisjet e disponueshme për zbutjen.
147. Një nga kontributet kryesore të procesit të shqyrtimit të planit të emergjencës vjen nga rezultatet e testimit të planit. Para testimit, duhet të jenë të vendosur objektivat për të gjitha aspektet e ushtrimit të një plani emergjence. Pas testit, shqyrtimi duhet të përqëndrohet në fushat ku objektivat nuk janë arritur. Duhet të regjistrohen rekomandimet nga shqyrtimet dhe testet si edhe veprimet e ndërmarra për të adresuar çdo rekomandim. Rishikimet e planeve të emergjencës duhet të vihen në zbatim në kohën e duhur dhe progresi duhet monitoruar.

3.10 Informimi dhe paralajmërimi i publikut

148. Operatori është i detyruar të sigurojë informacionin e duhur për njerëzit brenda zonës së informimit publik. Zona e informimit publik është zona ku njerëzit kanë gjasa për t'u prekur nga një aksident madhor. Kjo vendoset nga Autoriteti Kompetent duke marrë parasysh mundshmërinë dhe efektet e

mundshme të një aksidenti madhor në ndërmarrje. Informacioni minimal që duhet të ofrohet përcaktohet në Aneksin 5 të ligjit - por operatorët janë të lirë për të siguruar më shumë informacion në qoftë se dëshirojnë.

149. Është e rëndësishme të merret në konsideratë komunikimi i informacionit për fëmijët si edhe për të rriturit. Mund të konsiderohet përdorimi i paketave edukative për shkollat dhe kolegjet. Në disa vende mund të ketë nevojë për të përkthyer informacionin në gjuhë të tjera. Publikimi i informacionit mund të marrë forma të ndryshme të cilat duhet të jenë lehtësisht të arritshme dhe t'i rezistojnë kohës.
150. Duhet të ekzistojë një metodë efektive për paralajmërimin e publikut brenda zonës së informimit publik për një aksident madhor. Përveç kësaj, njerëzit jashtë zonës së informimit publik gjithashtu kanë nevojë për informacion që duhet të realizohet nga planet e emergjencës. Në qoftë se nuk janë marrë veprime për të risiguruar njerëzit jashtë zonës së informimit publik mund të ketë alarme të panevojshme.

3.11 Nevojat për informacion për shërbimet e emergjencës

151. Shërbimet e emergjencës do të kërkojnë informacion specifik për zhvillimin e veprimeve të tyre për t'u marrë me një aksident me rrezik madhor. Operatorët duhet të bashkëpunojnë sa më shumë që të jetë e mundur me shërbimet e emergjencës në mbledhjen dhe dhënien e këtij informacioni.

Shërbimi i zjarrfikëseve

152. Shërbimi i zjarrit do të kërkojë, të paktën, këto të dhëna, sipas rastit:
- a. Informacion në terma jo-teknike për planimetrinë e ndërtesave të ndërmarrjes, impjantin dhe aktivitetin e procesit, duke përfshirë të gjitha rreziqet e tjera përkatëse, p.sh. transformatorët elektrikë.
 - b. Vendodhjen e QKE(ve);
 - c. Identifikimin e personelit kyç, duke përfshirë specialistët brenda territorit që mund të japin këshilla;
 - d. Vendndodhjen e cilitdo shërbimi të zjarrfikëseve brenda territorit, qendrave mjekësore apo të ndihmës së parë;
 - e. Konfirmimin e niveleve të inventarit të substancave të rrezikshme brenda territorit dhe gjendjet e tyre fizike;
 - f. Informacionin që përshkruan disponueshmërinë e të dhënave teknike nga fletët e rrezikut që japin të dhëna të përgjithshme për veçoritë dhe natyrën fizike të substancave që kanë gjasa të hasen. Identifikoni kur ekziston një rrezik i madh nga temperaturat e larta / të ulëta, trysnitë e larta / të ulëta apo reaksionet katalitike gjatë një procesi prodhimi;
 - g. Informacionin mbi detajet e instalimeve fikse të mbrojtjes nga zjarri (ventilatorët e çative, spërkatësit, etj.) bashkë me detajet teknike të operimit të tyre dhe të gjitha rezervat.
 - h. Tregoni të gjitha instalimet e ngarkim shkarkimit së bashku me detajet teknike përkatëse për funksionimin e tyre;
 - i. Identifikoni, në konsultim me autoritetet e mjedisit, karakteristikat e të gjitha rrjedhave ujore, interceptorëve dhe sistemeve të kullimit të impjantit që kanë për qëllim zbutjen e ndotjes së mjedisit jashtë

territorit dhe identifikimin e çdo pajisjeje të nevojshme për ta ndihmuar këtë gjë, të tilla si mbrojtës për kullimin, gjësimet, etj;

- j. Identifikoni të gjitha tubacionet e naftës ose gazit;
- k. Detajet e tipeve dhe aftësisë së cilësdo paisje monitoruese të ndërmarrjes për të vlerësuar të gjitha shkarkimet toksike, të djegshme apo radioaktive;
- l. Detajet e të gjithë sistemeve që japin informacion meteorologjik, përfshirë modelimin sipas shtëllungave;
- m. Konfirmoni të gjitha masat e sigurisë në ndërmarrje (si qentë, gardhet elektrike, etj.) që mund të ndikojnë tek taktikat operacionale.

153. Shërbimet e zjarrfikëseve do të kërkojnë gjithashtu detaje për mënyrat e hyrjes dhe daljes nga ndërmarrja, siç janë:

- a. Një strategji për qasje të sigurt tek ndërmarrja, pavarësisht nga lloji i aksidentit, me alternativa praktike;
- b. Identifikimi i hyrjes dhe rrugëve të sigurta brenda kufijve të ndërmarrjes;
- c. Identifikimi i të gjitha veçorive të ndërtimit apo rreziqeve strukturore që mund të kenë një efekt në luftën kundër zjarrit apo operacionet e shpëtimit;

154. Shërbimi i zjarrfikëseve do të kërkojë informacion mbi vendndodhjen e shërbimeve, të tilla si:

- a. Vendndodhja dhe disponueshmëria në raste emergjente e çelësave kryesorë të izolimit dhe valvulave për linjat e prodhimit dhe shërbimeve themelore të tilla si gazi, energjia elektrike dhe furnizimet me ujë;
- b. Identifikoni ekzistencën e zbulimit të zjarrit automatik dhe sistemet e shtypjes, duke përfshirë llojin e shërbimit dhe pikat e tyre respektive të kontrollit;
- c. Konfirmoni disponueshmërinë e furnizimit me energji elektrike ose ndriçim për rastet e emergjencës.

155. Për sa i përket furnizimit me ujë, shërbimi i zjarrfikëseve do të kërkojë informacion për:

- a. Identifikimin e disponueshmërinë dhe përshtatshmërisë së furnizimit me ujë për të luftuar zjarrin, ftohjen e enëve ose shtypjen e gazit dhe shtëllungave të avullit;
- b. Përlllogaritjet e kërkesës së vlerësuar për një situatë serioze zjarri, të përfshijnë kërkesat për furnizime nga instalimet fikse;
- c. Të marrë në konsideratë potencialin që uji që derdhet të ripërdoret në operacionet e luftës kundër zjarrit;
- d. Të konfirmojë vendndodhjen e aktivizimit manual ose pikat e shtypjes për pompat e zjarrit dhe instalimet fikse;
- e. Detajoni të gjitha alternativat e furnizimeve me ujë dhe konfirmoni sasi e ujit në dispozicion.

156. Për qëllime të luftimit taktik të zjarrit, shërbimi i zjarrfikëseve do të kërkojë informacion për:

- a. Identifikoni vendodhjen e përshtatshme për praninë fillestare, përfshirë pikat e caktuara të takimit;
- b. Hartoni një strategji të paraplanifikuar për të përdorur maksimalisht paisjet për të luftuar zjarrin, etj.;
- c. Hartoni një strategji të paraplanifikuar për të vlerësuar sasinë maksimale të ujit kundër zjarrit që derdhet dhe nevojat për kontroll nëse ekziston risku i ndotjes së rrjedhave ujore;
- d. Merrni në konsideratë nevojën dhe shkallën e paisjeve të aparaturave të frymëmarrjes, paisjet e mbrojtjes personale dhe masat e dekontaminimit;
- e. Identifikoni vendodhjet më të mira për njësitë e komandove të shërbimit të zjarrfikësve, etj.;
- f. Vendodhjen e spitalit më të afërt për ekspozimet kimike dhe toksike, përfshirë nëse kërkohen antidote;
- g. Merrni në konsideratë të gjithë faktorët e tjerë që mund të ndikojnë në potencialin për të përballuar aksidentin;
- h. Lista e prioriteteve të shpëtimit;
- i. Identifikimi i disponueshmërisë së mekanizmave që mund të sigurojnë mbylljen e sigurt të impjantit ose paisjes në rast emergjence si edhe ndikimin e këtyre izolimeve të emergjencës në pjesë të tjera të impjantit;
- j. Identifikimi i disponueshmërisë së impjanteve të komunikimeve jashtë territorit.

157. Shërbimi i zjarrfikësve do të kërkojë informacion gjithashtu:

- a. Për të identifikuar numrin e njerëzve që kanë gjasa të jetë në territor në çfarëdo kohe (ditë apo natë) dhe procedurat përkatëse për evakuim;
- b. Për të marrë në konsideratë përdorimin e pikave të mbledhjes apo strehimit dhe nevojën për shërbimin e zjarrfikësve për të marrë konfirmimin e apelit;
- c. Për të shqyrtuar politikat dhe proceset e projektuara për të këshilluar publikun për rreziqet që kanosen.

Policia

158. Policia do të kërkojë informacion specifik për territorin dhe incidentin siç është:

- a. Emri dhe numri i telefonit të territorit;
- b. Numri i të punësuarve në territor;
- c. Përshkrimi i incidentit;
- d. Vendodhja e saktë e territorit dhe pikat e hyrjes me alternative;
- e. Detajet e kimikateve të përfshira;
- f. Efektet e mundshme, në terma të përgjithshme;
- g. Shpejtësia dhe drejtimi i erës locale, po të dihet;
- h. Vlerësimi i implikimeve të mundshme jashtë territorit, në qoftë se dihen;
- i. Çdo veprim proaktiv që publiku duhet të marrë;
- j. Detaje për të lënduarit dhe/ose viktimat;
- k. Veprimet që po merren për të përballuar këtë incident.

159. Gjithashtu policia do të duhet të dijë:

- a. Vendodhjen e QKE(ve);
- b. Identitetin e personelit kryesor;
- c. Ku dhe me kë duhet të lidhet policia në vendngjarje;
- d. Për përgjigjen fillestare – të gjitha masat e veçanta që duhet të ndërmerren, së bashku me çdo këshillë për shëndetin dhe sigurinë për zyrat që janë të pranishme në detyrë.

Shërbimi i ambulancës

160. Shërbimi i ambulancës do të kërkojë informacion të tillë si:
- a. Identifikoni vendodhjen dhe pikat e hyrjes, me alternativa;
 - b. Konfirmoni operacionin komercial – çfarë bën ndërmarrja;
 - c. Detajoni inventarin e rrezikshëm;
 - d. Identifikoni rreziqet kryesore, si zjarri, shpërthimet apo shkarkimet toksike;
 - e. Jepni detaje për personelin mjekësor dhe impjantet e ndërmarrjes;
 - f. Konfirmoni numrin e stafit brenda territorit (ditën dhe natën);
 - g. Identifikoni vendodhjen e QKE(ve);
 - h. Identifikoni personelin kryesor;
 - i. Siguroni akses në planet e ndërmarrjes duke treguar planimetrinë e territorit;
 - j. Jepni informacion për të mundësuar shërbimin e ambulancës të kryejë vlerësimin e riskut për të përcaktuar kërkesat për pajisje personale mbrojtëse për shkak të kimikateve të përdorura në ndërmarrje;
 - k. Detajoni zonat e shpallura të sigurta për dekontaminimin;
 - l. Identifikoni vendndodhjen e çdo zone ulje për helikopterët e ambulancës.

Autoritetet Shëndetësore

161. Autoritetet lokale shëndetësore do të kërkojnë informacion, përfshirë:
- a. Konfirmoni operacionin komercial – çfarë bën ndërmarrja;
 - b. Listën e kimikateve të përdorura dhe të magazinuara në ndërmarrje (emri kimik dhe numri UN);
 - c. Për çdo kimikat;
 - i. Formën kimike,
 - ii. Risqet e njohura për shëndetin,
 - iii. Trajtimet e njohura,
 - iv. Ekzistencën dhe hyrjen për në antidotat brenda territorit;
 - d. Lista me numrat e telefonave të kontaktit;
 - e. Jepni informacion për të mundësuar autoritetin shëndetësor të kryjë vlerësimin e rrezikut për të përcaktuar kërkesat për pajisje personale mbrojtëse për shkak të kimikateve të përdorura në ndërmarrje.